



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 7

2001

Mars

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8738 datë 12.2.2001	Për një shtesë në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”	169
Ligj nr.8739 datë 12.2.2001	Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion.....	169
Ligj nr.8740 datë 15.2.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e OBPI-së“Për interpretimet, ekzekutimet dhe fonogramet”	176
Ligj nr.8741 datë 15.2.2001	Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare.....	190
Ligj nr.8742 datë 15.2.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit (IDB) për projektin e infrastrukturës rurale”	196

Vendim i Kuvendit nr.473, datë 26.2.2001	Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil.....	205
Vendim i Kuvendit Nr.474, datë 1.3.2001	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Zeqo, anëtar i Komisionit të Letrave me Vlerë.....	205
Vendim i KM nr.58, datë 2.2.2001	Për shfuqizimin e vendimit nr.575, datë 2.9.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për furnizimin me karburante të ndërmarrjeve e të institucioneve, buxhetore dhe jobuxhetore, nga “Albpetrol”, Sh.a, Patos”.....	206
Vendim i KM nr.64, datë 2.2.2001	Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre.....	206
Udhëzim i MPL nr.1, datë 24.1.2001	Për funksionimin e KRRT-ve.....	209
Vendim i Gj.K nr.4 datë 7.2.2001	Me objekt: “Deklarimin si antikushtetues të vendimeve nr.119. datë 13.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr.253, datë 28.12.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr,78, datë 25.2.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”	210

LIGJ
Nr. 8738, datë 12.2.2001

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8378, DATË 22.7.1998
“KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” në nenin 121 pika 5, në fund të rreshtit të dytë pas fjalëve “para vitit 1974,” shtohen fjalët “dhe ka punuar në ndërmarrjet dhe sektorët e transportit për më shumë se pesë vjet ose që ka qenë drejtues autoskolle mbi pesë vjet,”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2905, datë 20.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

LIGJ
Nr. 8739, datë 12.2.2001

PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE NËN PRESION

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë garantimin e sigurisë së njerëzve, kafshëve shtëpiake ose vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga pajisjet nën presion.

Neni 2
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Enët e thjeshta nën presion” kuptohen enët e salduara, të përcaktuara të mbajnë ajër ose azot dhe të mos i ekspozohen flakës.
2. “Futja në treg” kuptohet livrimi ose vënia në dispozicion të të tretëve të pajisjeve nën presion.
3. “Inspektorat i përdoruesve” kuptohet një trup inspektimi i miratuar nga IPNP-ja dhe i autorizuar nga Ministri përkatës, që kryen detyrat e përcaktuara në aktet nënligjore të nenit 3 të këtij ligji.
4. “IPNP” kuptohet Inspektorati i Pajisjeve nën Presion.
5. “Kontroll teknik” kuptohet inspektimi i organizuar në periudhë të caktuar kohe dhe kur është e nevojshme jashtë këtyre periudhave për verifikimin e plotësimit të kërkesave thelbësore të sigurisë.
6. “Pajisje nën presion stacionare” kuptohen enët, tubacionet, aksesoret e sigurisë dhe aksesoret nën presion.
7. “Pajisje nën presion” kuptohen pajisjet nën presion stacionare, enët e thjeshta nën presion dhe pajisjet transportuese nën presion, me presion maksimal të lejuar më të madh se 0,5 bar.
8. “Pajisjet transportuese nën presion” kuptohen enët që mbushen me fluid dhe që transportohen pas mbushjes për t’u shkarkuar.
9. “Përdorimi i pajisjeve nën presion” kuptohet vënia në shfrytëzim ose heqja nga puna, përdorimi, transporti, riparimi, përshtatja, mirëmbajtja dhe pastrimi i pajisjeve nën presion.
10. “Trup inspektues palë e tretë” kuptohet një ent i autorizuar nga IPNP-ja, për të kryer detyrat e përcaktuara në aktet nënligjore të nenit 3 të këtij ligji.

KREU II
KËRKESAT THELBËSORE TË SIGURISË SË PAJISJEVE NËN PRESION

Neni 3
Kërkesat thelbësore të sigurisë

1. Pajisjet nën presion duhet të plotësojnë kërkesat kryesore të sigurisë të përcaktuara në aktet nënligjore të projektimit, të prodhimit, të vlerësimit të konformitetit, të përdorimit dhe kontrollit teknik për secilin grup pajisjesh nën presion.
2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të pikës 1 të këtij neni.

Neni 4
Futja në treg

1. Pajisjet nën presion lejohen të futen në treg dhe të vihen në shfrytëzim vetëm nëse nuk përbëjnë rrezik për sigurinë e njerëzve dhe, kur është rasti, të kafshëve shtëpiake e të vlerave materiale, po të vendosen pa të meta, e të mirëmbahen siç duhet dhe të përdoren në përputhje me destinacionin e tyre.
2. Para futjes në treg, prodhuesi ose importuesi është i detyruar që çdo pajisje nën presion ta pajisë me certifikim nga IPNP-ja, për të vërtetuar plotësimin e kërkesave thelbësore të sigurisë, sipas nenit 3 të këtij ligji. Certifikimi bëhet pasi merret më parë miratimi i përshtatshmërisë së mjeteve matëse të pajisjeve nga organi kompetent.
3. Lejohet futja në treg e pajisjeve nën presion që janë të certifikuara nga organizma të huaj, në marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve.

Neni 5
Mbikëqyrja e tregut

1. Kur IPNP-ja vëren se një pajisje nën presion, e përdorur në përputhje me destinacionin e saj, rrezikon sigurinë e njerëzve dhe, kur është rasti, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale, merr masat e nevojshme për ta hequr pajisjen nga tregu dhe nga shfrytëzimi.

2. Masa e marrë i bëhet e njohur menjëherë të interesuarve. Kundër masës së marrë mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 6
Kontrolli teknik

1. Pas instalimit, pajisjet nën presion i nënshtrohen kontrollit teknik të vënies në punë dhe të regjistrimit të tyre nga IPNP-ja. Kur pajisja plotëson kërkesat dhe kur kushtet e instalimit garantojnë sigurinë e pajisjes nën presion, IPNP-ja lëshon lejen e vënies në shfrytëzim.

Pas çdo montimi në një vend tjetër ose pozicion tjetër, pajisja nën presion i nënshtrohet kontrollit teknik dhe marrjes së lejes të vënies në shfrytëzim nga IPNP-ja.

2. Personi juridik që përdor pajisje nën presion merr të gjitha masat për të kryer kalibrimin periodik të mjeteve matëse të pajisjes dhe kontrollin teknik periodik të çdo pajisjeje nën presion sipas llojeve, afateve dhe vlerave të presionit të provës së përcaktuara në lejen e punës së IPNP-së, e cila përsëritet pas çdo kontrolli teknik periodik.

3. Pajisjet nën presion u nënshtrohen kontrolleve teknike të posaçme nga IPNP-ja në çdo kohë, kur paraqiten rrethana të veçanta, që janë të lidhura me vënien në rrezik të pajisjeve, si punime modifikuese, avari, aksidente ose periudha të zgjatura të mosvënies në shfrytëzim, për t'u siguruar se janë ruajtur kushtet e sigurisë dhe për të zbuluar dhe mënjanuar në kohë dëmtimet.

4. Rezultatet e kontrolleve teknike regjistrohen dhe u lihen në dizpozicion IPNP-së dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës. Në rast se pajisja nën presion do të përdoret nga një subjekt tjetër, ajo shoqërohet me dëshminë fizike të kryerjes së kontrollit të fundit teknik.

5. Kontrollat teknike kryhen nga IPNP-ja, nga një trupë inspektuese palë e tretë ose nga një inspektorat përdoruesish.

KREU III
PËRDORIMI I PAJISJEVE NËN PRESION

Neni 7
Detyrime të punëdhënësit

1. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet nën presion, të vëna në dispozicion të punëmarrësve, të jenë të përshtatshme për punën që do të kryhet, duke garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësit gjatë përdorimit.

2. Punëdhënësi duhet të vërë në përdorim pajisje nën presion që plotësojnë kërkesat e pikës 1 të nenit 3.

3. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet nën presion, gjatë përdorimit, të mirëmbahen në një nivel të tillë, që të plotësohen kërkesat e pikës 2 të nenit 3.

Neni 8
Njohja me të dhënat e punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masa që punëmarrësit të disponojnë të dhënat e duhura dhe udhëzimet e përdorimit të pajisjeve nën presion që kanë në përdorim.

2. Të dhënat dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve nën presion duhet të përmbajnë të paktën treguesit për sigurinë dhe shëndetin, përsa u përket:
 - kushteve të shfrytëzimit të pajisjeve nën presion;
 - situatave anormale të parashikueshme;
 - c) dhënies së ndihmës së parë mjekësore në rast aksidenti.
3. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve nën presion duhet të jenë të kuptueshme për punëmarrësin.

Neni 9

Formimi i punëmarrësve

Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

- a) punëmarrësit e ngarkuar për përdorimin e pajisjeve nën presion të marrin formim të majftueshëm edhe për rreziqet që përmban ky përdorim;
 - b) punëmarrësit e ngarkuar me riparimin, modifikimin ose mirëmbajtjen të kenë kualifikimin e duhur dhe të marrin formim të posaçëm për të kryer këto detyra.
2. Krahas kërkesës së pikës 1 të këtij neni, punëmarrësit e përdorimit të kaldajave të avullit dhe saldatorët e pajisjeve nën presion merren në provim dhe pajisen me patentë nga IPNP-ja.

Neni 10

Këqyrja e avarisë

1. Për çdo rast avarie në pajisjet nën presion ose të një aksidenti të shkaktuar nga pajisjet nën presion, punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij duhet të njoftojë IPNP-në për këqyrjen e avarisë.
2. Ndalohet riparimi ose ndryshimi i vendit të pajisjeve nën presion të dëmtuara deri në përfundimin e këqyrjes, përveç rastit kur rrezikohet jeta e njerëzve, ndotja e mjedisit dhe dëmtimi i mëtejshëm i pajisjes.
3. Punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij është i detyruar t'i japë IPNP-së çdo të dhënë që ka lidhje me kryerjen e këqyrjes.
4. Në rast aksidenti në punë, inspektori i IPNP-së bashkëpunon me inspektorin e punës në nivel vendor për këqyrjen e aksidentit.

KREU IV

INSPEKTORATI I PAJISJEVE NËN PRESION (IPNP)

Neni 11

Detyra e IPNP-së

IPNP-ja mbikëqyr zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 12

Statusi e drejtimi

1. IPNP-ja është person juridik dhe ka zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit.
2. Organizimi, funksionimi dhe struktura e IPNP-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. IPNP-ja drejtohet nga kryeinspektori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Neni 13
Detyrat e IPNP-së

Krahas detyrave për zbatimin e kërkesave të neneve të parashikuara më sipër, IPNP-ja kryen edhe këto detyra:

- a) Kontrollon plotësimin e kërkesave të sigurisë së pajisjeve nën presion për licencimin dhe regjistrimin e veprimtarisë nga autoriteti përgjegjës.
- b) Miraton projektin e vendosjes së kaldajave dhe të enëve nën presion stacionare.
- c) Autorizon trupat inspektues palë e tretë për kryerjen e detyrave të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji dhe rregulloret teknike.
- ç) Kryen inspektime në subjektet private ose publike që kryejnë veprimtari me pajisje nën presion.
- d) Jep miratim për autorizim nga ministri, të inspektorateve të përdoruesve për kryerjen e detyrave të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji.
- dh) Mban evidenca për gjendjen teknike, avaritë dhe regjistrimin e pajisjeve nën presion.

Neni 14
Të drejtat e IPNP-së

1. Për zbatimin e detyrave të caktuara nga ky ligj, IPNP-ja ka të drejtë të hyjë në çdo kohë në mjediset ku mund të ndodhen pajisje nën presion në punë.
2. Kur IPNP-ja vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregulloreve:
 - a) lë aktkontroll me detyra dhe afat për mënjanimin e shkeljeve;
 - b) lë aktndalesë, kur gjykon se një pajisje nën presion nuk garanton sigurinë;
 - c) heq patentën ose lejen e përdorimit për një periudhë kohe të caktuar ose përgjithmonë;
 - ç) merr masa administrative me gjobë, sipas nenit 17 të këtij ligji dhe, për raste shkeljesh të rënda të rregulloreve, me pasoja për jetën e njerëzve, kërkon ndjekje penale.
3. IPNP-ja, me kërkesën e përdoruesit, kur justifikohet me masat e marra, shtyn afatin e kryerjes së kontrollit teknik periodik për një kohëzgjatjeje të caktuar.
4. IPNP-ja kërkon ndërhyrjen e forcave të rendit:
 - a) kur inspektori cenohet gjatë kryerjes së detyrës;
 - b) kur nuk zbatohet urdhri i ndalesës së një pajisjeje nën presion, që përbën rrezik të hapur për jetën e njerëzve;
 - c) kur nuk lejohet të hyjë në lokale ku mund të ndodhen pajisje nën presion në punë.
5. IPNP-ja bashkëpunon me persona ose shërbime përkatëse publike ose private, për të kryer ekspertiza për krijimin e grupeve të punës dhe për kryerjen e kontrolleve të veçanta.

Neni 15
Burimet financiare

Burimet financiare të IPNP-së janë:

Buxheti i Shtetit;

b) të ardhurat me destinacion, që realizohen nga shërbimet për të tretët.

2. IPNP-ja realizon të ardhura nga shërbimet që kryhen në subjektet private dhe publike nga:

a) veprimtaria kryesore sipas neneve 4, 6 dhe 9. Tarifatat për këto të ardhura caktohen nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;

b) të ardhurat me destinacion nga shërbimet për të tretët. Këto të ardhura derdhen në llogarinë e IPNP-së dhe përdoren nga ajo për mbulimin e shpenzimeve të kryera, ndërsa 10 për qind e tyre i kalojnë Buxhetit të Shtetit. Tarifatat për këto të ardhura caktohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Neni 16
Pavarësia dhe paanshmëria

1. IPNP-ja, kryeinspektori dhe inspektorët nuk mund të jenë projektues, prodhues, furnizues, montues dhe përdorues të pajisjeve nën presion që kontrollojnë dhe as përfaqësues të tyre.

Ata nuk mund të ndërhyjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në projektimin, prodhimin, tregtimin ose mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve nën presion, as të përfaqësojnë palë që marrin pjesë në këto veprimtari.

Kjo nuk përjashton mundësinë e shkëmbimit të të dhënave teknike, ndërmjet prodhuesit, montuesit e përdoruesit të pajisjes nën presion dhe IPNP-së.

2. Inspektorët e IPNP-së duhet të kryejnë veprimet e vlerësimit me aftësi profesionale e me përgjegjësi të plotë teknike dhe të jenë të lirë nga çfarëdo presioni ose nxitjeje, sidomos të natyrës financiare, që mund të ndikojë në gjykimin e tyre ose në rezultatin e kontrollit, në mënyrë të veçantë nëse vijnë nga persona ose grupe personash të interesuar për rezultatet e verifikimeve.

3. Inspektorët e IPNP-së duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në fuqi për trupat e inspektimit lidhur me formimin profesional, njohjen e kërkesave për kontrollat që kryejnë dhe me përvojën për këto kontrole, si dhe aftësi për të hartuar certifikimet, procesverbalet dhe relacionet ku konkretizohen kontrollat e bëra.

4. Inspektorët në kryerjen e detyrës së tyre duhet të jenë të paanshëm.

5. Personeli i IPNP-së ruan sekretin profesional për gjithçka që vihet në dijeni gjatë ushtrimit të veprimtarisë sipas këtij ligji. Nëse personeli i IPNP-së, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, nxjerr ndonjë sekret të prodhimit ose të tregtimit të proceseve të punës, ndaj tij merren masa disiplinore të përcaktuara në rregulloren e brendshme të IPNP-së.

Neni 17
Kundërvajtjet administrative

Janë kundërvajtje administrative:

a) shkeljet e neneve 3, 4, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji, që rrezikojnë sigurinë e njerëzve, të kafshëve shtëpiake dhe të vlerave materiale;

b) shkeljet e përsëritura të shënuara në aktkontrollat e lëna nga IPNP-ja;

c) tejkalimi i afatit të lënë nga IPNP-ja për mënjanimin e shkeljeve.

2. Kur shkelja nuk përbën vepër penale, punëdhënësi ose punonjësi i caktuar për mbikëqyrjen teknike, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë.

Inspektori i IPNP-së që vëren shkeljen harton në vend procesverbalin për shkeljen dhe i propozon kryeinspektorit të marrë masën e dënimit me gjobë.

3. Masa e gjobës është nga 2000 deri në 500 000 lekë. Mënyra e llogaritjes së gjobës bëhet sipas rregullave të nxjerra nga IPNP-ja dhe të miratuara nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Komisioni i shqyrtimit të gjobave të IPNP-së që mblidhet dhe drejtohet nga Kryeinspektori, i shqyrton kundërvajtjet administrative jo më vonë se 15 ditë nga data e mbajtjes së procesverbalit.

5. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet në praninë e kundërvajtësit. Kur vërtetohet se ai ka marrë dijeni dhe nuk ka shkaqe justifikuese për mosparaqitje, shqyrtimi mund të bëhet edhe në mungesë.

6. Kundër vendimit të Komisionit të IPNP-së për shqyrtimin e gjobave, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 18
Ekzekutimi i gjobës

1. Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

Pas kalimit të këtij afati për çdo ditë vonesë paguhet një kamatë prej 2 për qindësh deri në një muaj. Kur gjoba pas këtij afati nuk paguhet, zbatohet ligji nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

2. Gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 19
Shfuqizime

Dekreti nr.2170, datë 5.12.1955 “Për Inspektoratin Shtetëror të Pajisjeve nën Presion” dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2906, datë 20.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIGJ
Nr. 8740, datë 15.2.2001

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN
E OBPI-SË “PËR INTERPRETIMET, EKZEKUTIMET DHE FONOGRAMET”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Traktatin e OBPI-së “Për interpretimet, ekzekutimet dhe fonogramet”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2909, datë 27.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Traktati i OBPI-së mbi Interpretimet, Ekzekutimet dhe Fonogramet
(TOIEF) (1996)

MARRËVESHJA

E KONFERENCËS DIPLOMATIKE QË ADOPTOI TRAKTATIN DHE MBROJTJA E
KONVENTËS SË BERNËS (1971) DHE E KONVENTËS SË ROMËS (1961) PËRMENDUR NË
TRAKTAT. OBPI ORGANIZATA BOTËRORE E PRONËSISË INTELEKTUALE

PËRMBAJTJA

Traktati i OBPI-së për Interpretimet, Ekzekutimet dhe Fonogramet (TOIEF) (1996).

Parashikimet e Konventës së Bernës për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare (1971),
përmendur në TOIEF.

Dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Ekzekutuesve, Interpretuesve,
Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizmave Radioshpërndarëse (Konventa e Romës) (1961),
përmendur në TOIEF.

Traktati i Interpretimeve, Ekzekutimeve dhe Fonogrameve
(TOIEF) (1996)

PARATHËNIE

KREU 1: Dispozita të përgjithshme

Neni 1: Raportet me konventat e tjera

Neni 2: Përkufizime

Neni 3: Përfituesit e mbrojtjes së parashikuar prej këtij Traktati

Neni 4: Trajtimi kombëtar

KREU II: Të drejtat e artistëve interpretues dhe ekzekutues

Neni 5: E drejta morale e artistëve interpretues ose ekzekutues.

Neni 6: E drejta ekonomike e artistëve interpretues ose ekzekutues mbi
interpretimet ose ekzekutimet e tyre të pafiksuar

Neni 7: E drejta e riprodhimit

Neni 8: E drejta e shpërndarjes

Neni 9: E drejta e qirasë

Neni 10: E drejta për të vënë në dispozicion interpretimet apo ekzekutimet e fiksuara

KREU III: Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve

Neni 11: E drejta e riprodhimit

Neni 12: E drejta e shpërndarjes

Neni 13: E drejta e qirasë

Neni 14: E drejta për të vënë në dispozicion fonogramet

KREU IV: Dispozita të përbashkëta

Neni 15: E drejta për shpërblim për radioshpërndarjen dhe komunikimin në
publik

Neni 16: Kufizimet dhe përjashtimet

Neni 17: Kohëzgjatja e mbrojtjes

Neni 18: Detyrimet lidhur me masat teknike

Neni 19 : Detyrimet lidhur me informacionin mbi menaxhimin e të drejtave
Neni 20 : Formalitetet
Neni 21: Rezerva
Neni 22: Zbatimi në kohë
Neni 23: Dispozita lidhur me sanksionimin e të drejtave

KREU V: Dispozita administrative dhe klauzola të fundit

Neni 24: Asambleja
Neni 25: Zyra Ndërkombëtare
Neni 26 : Kushtet që duhen përmbushur për t'u bërë palë në Traktat
Neni 27 : Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Traktati
Neni 28 : Nënshkrimi i Traktatit
Neni 29 : Hyrja në fuqi e Traktatit
Neni 30 : Data e bërjes së zbatueshme të detyrimeve që rrjedhin nga Traktati
Neni 31: Denoncimi i Traktatit
Neni 32 : Gjuhët e Traktatit
Neni 33 : Depozituesi

PARATHËNIE

Palët kontraktuese,

Duke dëshiruar të zhvillojnë dhe të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të artistëve interpretues, ekzekutues dhe të fonogrameve në një mënyrë sa më efektive dhe të barabartë që të jetë e mundur,

Duke njohur nevojën të prezantojnë rregulla të reja ndërkombëtare në mënyrë që të mundësojnë zgjidhje të përshtatshme ndaj çështjeve të ngritura nga zhvillimet ekonomike, sociale, kulturore dhe teknologjike,

Duke njohur impaktet e thella të zhvillimit dhe përqëndrimit të teknikave të informimit dhe të komunikimit, mbi prodhimin dhe shfrytëzimin e interpretimeve apo ekzekutimeve dhe të fonogrameve,

Duke njohur nevojën për të ruajtur një ekuilibër midis të drejtave të artistëve interpretues ose ekzekutues dhe prodhuesve të fonogrameve me interesat e përgjithshme publike, veçanërisht në fushën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të hyrjes në informacion,

Bien dakord për sa më poshtë:

KREU I PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Raportet me konventat e tjera

1. Asnjë dispozitë e këtij Traktati nuk sjell shkelje ndaj detyrimeve ekzistuese që kanë palët kontraktuese me njëra-tjetrën sipas Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Artistëve Interpretues dhe Ekzekutues, të Prodhuesve të Fonogrameve dhe organizmave të radioshpërndarjes, bërë në Romë, më 26 tetor 1961(më tej “Konventa e Romës”).

2. Mbrojtja e garantuar nga ky Traktat nuk çënon dhe nuk prek në asnjë mënyrë mbrojtjen e së drejtës së autorit mbi veprat letrare dhe artistike. Si pasojë, asnjë dispozitë e këtij Traktati nuk do të interpretohet si kufizim i kësaj mbrojtjeje.¹

¹. Deklarata e miratuar në nenin 1(2): Kuptohet që neni 1(2) qartëson marrëdhënien mes të drejtave të fonogrameve të mbrojtura nga ky Traktat dhe të drejtat në punë të trupëzuara në fonogram. Në rastet kur nevojitet autorizimi si nga autori i punës së trupëzuar në fonogram edhe nga ekzekutuesi apo prodhuesi që ka

3. Ky Traktat nuk do të ketë asnjë lidhje me traktatet e tjera dhe zbatohet pa paragjykimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin prej çdo traktati tjetër.

Neni 2 Përkufizime

Në kuptim të këtij Traktati

a) "Artistë interpretues dhe ekzekutues" janë aktorët, këngëtarët, muzikantët, kërcimtarët dhe persona të tjerë të cilët shfaqin, këndojnë, recitojnë, deklamojnë, interpretojnë, luajnë, apo ekzekutojnë në çfarëdo mënyre tjetër vepra letrare, punë artistike ose shprehje të folklorit.

b) "Fonogram" do të thotë fiksion i një tingulli ose i disa tingujve, që vjen nga një interpretim apo ekzekutim ose nga prezantimi i këtyre tingujve, të ndryshëm nga forma e një fiksioni të trupëzuar në një vepër kinematografike apo një vepër tjetër audiovizuale 2.

c) "Fiksion" do të thotë trupëzim i tingujve apo i shfaqjes së tyre, në një mbajtës që lejon t'i perceptosh, t'i riprodhosh apo t'i komunikosh me ndihmën e një dispozitivi (mekanizmi).

d) "Prodhues i një fonogrami" është personi fizik ose juridik që merr iniciativën dhe ka përgjegjësinë e regjistrimit të parë të tingujve që vijnë prej një interpretimi apo ekzekutimi ose tingujve të tjerë apo shfaqjeve të tingujve.

e) "Publikimi" i një interpretimi apo ekzekutimi të fiksuar ose i një fonogrami do të thotë vënia e kopjeve të interpretimit apo ekzekutimit të fiksuar ose të fonogrameve, në dispozicion të publikut, me pëlqimin e titullarit të të drejtave dhe me kushtin që këto kopje të jenë në sasi të mjaftueshme.³

f) "Radioshpërndarje" do të thotë: transmetim ose shfaqje pa fill i tingujve apo i tingujve dhe pamjeve, me qëllim marrjen e tyre prej publikut; do të thotë gjithashtu transmetim me satelit; transmetimi i sinjaleve të fshehura konsiderohet radioshpërndarje, atëhere kur mjetet e deshifrimit i jepen publikut me anë të organizatës së radioshpërndarjes ose me pëlqimin e saj.

g) "Komunikimi me publikun" i një ekzekutimi, interpretimi ose i një fonogrami do të thotë transmetim në publik me të gjitha mjetet e tjera, veç atyre të radioshpërndarjes, të tingujve që vijnë nga një ekzekutim ose të tingujve apo shfaqjeve të tingujve të fiksuara mbi një fonogram. Sipas qëllimeve të nenit 15, termi "komunikim në publik" kupton gjithashtu faktin e të bërit të dëgjueshëm prej publikut të tingujve ose të shfaqjes së tingujve të fiksuara mbi një fonogram.

Neni 3 Përfituesit e mbrojtjes së parashikuar prej këtij Traktati.

1. Palët kontraktuese i japin mbrojtjen e parashikuar prej këtij Traktati, artistëve interpretues ose ekzekutues dhe prodhuesve të fonogrameve, që janë shtetas të palëve të tjera kontraktuese.

2. Me shtetas të palëve të tjera kontraktuese duhen kuptuar artistët interpretues apo ekzekutues ose prodhuesit e fonogrameve që do t'i përgjigjeshin kriterëve të kërkuara për të përfituar mbrojtjen e parashikuar prej Konventës së Romës, pra do të ishin palë kontraktuese të këtij Traktati shtetet kontraktuese të asaj Konvente. Përsa i përket këtyre kriterëve të mbrojtjes, palët kontraktuese zbatojnë përkufizimet e nenit 2 të këtij Traktati.⁴

të drejta në fonogram, nevoja për autorizimin e autorit nuk ndalon se ekzistuari pasi kërkohet edhe autorizimi i producentëve dhe ekzekutuesve dhe e kundërta.

². Deklarata e aprovuar në nenin 2(b): Kuptohet që përcaktimi i fonogramit, i garantuar nga neni 2(b) nuk sugjeron se të drejtat në fonogram janë në njëfarë mënyre të ardhura nga bashkëpunimi i punëve kinematografike dhe audiovizuale.

³. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 2(e),8,9,12,13: Sikurse përmendet në këto nene shprehja "kopje" dhe "origjinali dhe kopjet", kushtëzuar nga të drejtat e shpërndarjes dhe e të drejtave të qirasë përmendur në këto nene, i referohet ekskluzivisht kopjeve të fiksuara që mund të vendosen në qarkullim si objekte të prekshme.

⁴. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 3(2): Në zbatimin e nenit 3(2), me fiksion do të kuptojmë finalizimin

3. Çdo palë kontraktuese që përdor të drejtën e parashikuar sipas nenit 5.3 të Konventës së Romës ose sipas qëllimeve të nenit 5 të kësaj Konvente, sipas nenit 17 të saj, i drejton një njoftim në kushtet e parashikuara në këto dispozita Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI).⁵

Neni 4

Trajtimi kombëtar

1. Çdo palë kontraktuese i akordon shtetasve të palëve të tjera kontraktuese, sikurse përkufizohet në nenin 3(2), trajtimin që palët kontraktuese i akordojnë shtetasve të saj, përsa i përket të drejtave ekskluzive të njohura shprehimisht në këtë Traktat dhe të drejtën e shpërblimit të duhur të parashikuar në nenin 15 të këtij Traktati.

2. Detyrimi i parashikuar në paragrafin (1) nuk zbatohet në masën që një palë kontraktuese përdor rezervimet e lejuara nga neni 15.3 i këtij Traktati.

KREU II

TË DREJTAT E ARTISTËVE INTERPRETUES OSE EKZEKUTUES

Neni 5

E drejta morale e artistëve interpretues apo ekzekutues

1. Pavarësisht nga të drejtat e tyre ekonomike edhe pas cedimit (transferimit) të këtyre të drejtave, artisti interpretues, përsa i përket interpretimit të tij zanor (së gjalli) apo interpretimeve të tij ose ekzekutimeve të fiksuara mbi fonograme, ruan të drejtën të kërkojë të përmendet si interpretuesi i ekzekutimit të tij, me përjashtim të rastit kur mohimi diktohet nga një mënyrë e përdorimit të interpretimit apo ekzekutimit që detyron mospërmendjen e emrit dhe i kundërvihet çdo deformimi, gjymtimi ose ndryshimi tjetër të këtyre interpretimeve apo ekzekutimeve apo çdo cenimi të tyre, që dëmton famën (emrin) e tij.

2. Të drejtat e njohura artistit interpretues, në përputhje me paragrafin (1), pas vdekjes së tij, do të mbeten të paktën deri në shuarjen e të drejtave pasurore dhe do të ushtrohen prej personave apo institucioneve të cilëve ua jep këtë cilësi (të drejtë) legjislacioni i palës kontraktuese, ku është kërkuar mbrojtja. Megjithatë, legjislacioni në fuqi i palëve kontraktuese që në momentin e ratifikimit të këtij Traktati apo të aderimit në të, nuk përmban dispozita që sigurojnë pas vdekjes së artistit interpretues apo ekzekutues, mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njohura sipas paragrafit të mësipërm, kanë cilësinë të parashikojnë që disa nga këto të drejta nuk do të ruhen pas vdekjes së artistit interpretues apo ekzekutues.

3. Mjetet e përdorura për të ruajtur të drejtat e njohura në këtë nen janë rregulluar prej legjislacionit të palës kontraktuese ku është kërkuar mbrojtja.

Neni 6

Të drejtat pasurore të artistëve interpretues apo ekzekutues mbi interpretimet apo ekzekutimet e pafiksuara.

Artistët interpretues apo ekzekutues gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar, lidhur me interpretimet apo ekzekutimet e tyre;

(i) radiodifuzimi dhe komunikimi me publikun i interpretimeve dhe ekzekutimeve të tyre të pafiksuara, përveç kur interpretimi apo ekzekutimi është tashmë një interpretim apo ekzekutim i radiodifuzuar dhe

e regjistrimit kryesor (“bandë-mere”).

⁵. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 3: Kuptohet se referenca në nenin 5(a) dhe 16(a) (iv) e Konventës së Romës për “kombas të një shteti tjetër kontraktues” kur zbatohet në këtë Traktat, përsa i përket një organizate ndërqeveritare e cila është një palë kontraktore e këtij Traktati, do të thotë shtetas i një vendi që është anëtar i kësaj organizate.

(ii) fiksimi i interpretimeve apo ekzekutimeve të tyre të pafiksuar.

Neni 7

E drejta e riprodhimit

Artistët interpretues do të gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar riprodhimin direkt ose indirekt të interpretimeve të tyre të fiksuara në fonograme, në çfarëdo mënyre apo formë qoftë.⁶

Neni 8

E drejta e shpërndarjes.

1. Artistët interpretues do të gëzojnë të drejtën ekskluzive, për të autorizuar, vënien në dispozicion të publikut të origjinalit dhe të kopjeve të interpretimeve apo ekzekutimeve të tyre të fiksuara në fonogram, me anë të shitjes apo me çdo kalim tjetër të pronësisë.

2. Asnjë dispozitë e këtij Traktati nuk cenon të drejtën që kanë palët kontraktuese për të përcaktuar kushtet, nëse ka të tilla, nën të cilat mbarimi i të drejtave shprehur në paragrafin (1) aplikohen pas shitjes së parë apo kalimit në një formë tjetër të pronësisë, të origjinalit ose të një kopjeje të interpretimit apo ekzekutimit të fiksuar, me autorizimin e artistit interpretues.⁷

Neni 9

E drejta e qirasë

1. Artistët interpretues apo ekzekutues gëzojnë të drejtën ekskluzive, për të autorizuar qiradhënien e origjinalit dhe të kopjeve të interpretimeve apo ekzekutimeve të tyre, të fiksuara mbi fonograme, sipas përkufizimit të legjislacionit kombëtar të palëve kontraktuese, edhe pas shpërndarjes të tyre prej vetë artistëve apo me autorizimin e tyre.

2. Pa rënë në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1), një palë kontraktuese që në 15 prill 1994 kishte në fuqi dhe vazhdon të ketë një sistem shpërblimi të drejtë të prodhuesve të fonogrameve, mund ta ruajë këtë sistem me kusht që qiradhenia tregtare e fonogrameve nuk shkakton dëmtim material të të drejtave ekskluzive riprodhuese, të prodhuesve të fonogrameve.⁸

Neni 10

E drejta e vënies në dispozicion të interpretimeve apo ekzekutimeve të fiksuara.

Artistët interpretues dhe ekzekutues gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar vënien në dispozicion të publikut me apo pa fill të interpretimeve apo ekzekutimeve të tyre të fiksuara mbi fonograme, në mënyrë që secili të mund të hyjë në to në vendin dhe në momentin që ai zgjedh individualisht.

⁶. Deklarata e aprovuar, lidhur me nenet 7, 11 dhe 16: E drejta e riprodhimit sikundër del nga neni 7 dhe 11, dhe përjashtimeve të parashikuara nga neni 16, zbatohen plotësisht në ambiente digjitale, në veçanti në përdorimin e interpretimeve dhe fonogrameve në formë digjitale. Kuptohet se ruajtja e interpretimeve të mbrojtura dhe fonogrameve në formë digjitale në një mjet elektronik përbën riprodhim brenda kuptimit të këtij neni.

⁷. Deklarata e aprovuar, lidhur me nenin 2 (e), 8, 9, dhe 13: Sikurse përdoret në këto nene, shprehja "kopje" dhe "origjinali dhe kopjet", kushtëzuar nga të drejtat e shpërndarjes dhe e të drejtave të qirasë përmendur në këto nene, i referohen ekskluzivisht kopjeve të fiksuara që mund të vendosen në qarkullim si objekte të prekshme.

⁸. Deklarata e aprovuar, lidhur me nenet 2(e), 8, 9, 12 dhe 13: Sikundër përdoret në këto nene, shprehjet "kopje" dhe "origjinali dhe kopjet" kushtëzuar nga të drejtat e shpërndarjes dhe e të drejtave të qirasë përmendur në këto nene, i referohet ekskluzivisht kopjeve të fiksuara që mund të vendosen në qarkullim si objekte të prekshme.

KREU III TE DREJTAT E PRODHUESVE TE FONOGRAMEVE

Neni 11 **E drejta e riprodhimit**

Prodhuesit e fonogrameve gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar riprodhimin direkt ose indirekt të fonogrameve të tyre, në çfarëdo mënyrë ose formë. 9

Neni 12 **E drejta e shpërndarjes**

1. Prodhuesit e fonogrameve gëzojnë të drejtën ekskluzive, të autorizojnë vënien në dispozicion të publikut, të origjinalit dhe kopjeve të fonogrameve të tyre nëpërmjet shitjes ose të çdo kalimi tjetër të pronësisë.

2. Asnjë dispozitë në këtë Traktat nuk do të cenojë të drejtën që kanë palët kontraktuese për të përcaktuar kushtet eventuale, me të cilat zbatohet mbarimi i të drejtës së shprehur në paragrafin (1) pas shitjes së parë ose kalimit në një mënyrë tjetër të pronësisë, të origjinalit apo të një kopjeje të fonogramit, të bërë me autorizimin e prodhuesit të fonogramit.10

Neni 13 **E drejta e qirasë**

1. Prodhuesit e fonogrameve gëzojnë të drejtën ekskluzive të autorizojnë qiramarrjen publikut, të origjinaleve ose të kopjeve të fonogrameve të tyre, edhe pas shpërndarjes me autorizimin ose prej vetë atyre.

2. Pa rënë në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1), një palë kontraktuese, që në 15 prill 1994 kishte në fuqi dhe vazhdon të ketë një sistem shpërblimi të drejtë të prodhuesve të fonogrameve, mund ta ruajë këtë sistem me kusht që qiradhënia tregtare e fonogrameve nuk shkakton dëmtim material të të drejtave ekskluzive riprodhuese, të prodhuesve të fonogrameve.11

Neni 14 **E drejta e vënies në dispozicion të fonogrameve**

Prodhuesit e fonogrameve gëzojnë të drejtën ekskluzive të autorizojnë vënien në dispozicion të publikut, të fonogrameve të tyre, me ose pa fill, në atë mënyrë që secili të hyjë në to, në vendin dhe në momentin që ai zgjedh individualisht.

⁹. Deklarata e aprovuar lidhur me nenet 7,11 dhe 16: E drejta e riprodhimit sikundër del nga neni 7 dhe 11, dhe përjashtimeve të parashikuara nga neni 16, zbatohen plotësisht në ambientin digjital, në veçanti në përdorimin e interpretimeve dhe fonogrameve në formë digjitale. Kuptohet se ruajtja e interpretimeve të mbrojtura dhe fonogrameve në formë digjitale në një mjet elektronik perben një riprodhim brenda kuptimit të këtij neni.

¹⁰. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 2(e),8,9,dhe 13: Sikurse përdoret në këto nene, shprehja "kopje" dhe "origjinali dhe kopjet" kushtëzuar nga e drejta shpërndarjes dhe e të drejtave të qirasë përmendur në këto nene, i referohet ekskluzivisht kopjeve të fiksuara që mund të vendosen në qarkullim si objekte të prekshme.

¹¹. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 2(e),8,9,dhe 13: Sikurse përdoret në këto nene, shprehja "kopje" dhe "origjinali dhe kopjet" kushtëzuar nga e drejta e shpërndarjes dhe e të drejtave të qirasë përmendur në këto nene, i referohet ekskluzivisht kopjeve të fiksuara që mund të vendosen në qarkullim si objekte të prekshme.

KREU IV DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 15

E drejta e shpërblimit për radioshpërndarjen dhe komunikimin në publik.

1. Artistët interpretues apo ekzekutues dhe prodhuesit e fonogrameve kanë të drejtën e një shpërblimi të drejtë dhe të vetëm për fonograme të publikuara për qëllime tregtie të përdorur direkt apo indirekt për radioshpërndarjen apo për një komunikim çfarëdo me publikun.

2. Palët kontraktuese mund të parashikojnë në legjislacionin e tyre kombëtar që shpërblimi i drejtë dhe i vetëm që i takon duhet t'i kërkohet përdoruesit, prej artistit interpretues apo ekzekutues ose prodhuesit të fonogramit, apo prej të dyve. Palët kontraktuese mund të vendosin (përshtasin) dispozita legjislative duke përcaktuar kushtet e shpërndarjes së shpërblimit të drejtë dhe të vetëm midis artistëve interpretues apo ekzekutues dhe prodhuesve të fonogrameve, në mungesë të marrëveshjes midis të interesuarve.

3. Çdo palë kontraktuese mund të deklarojë në një njoftim të paraqitur pranë Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së, që ajo do të zbatojë dispozitat e paragrafit (1) veçse ndaj disa përdoruesve, apo që ajo do t'a kufizojë zbatimin në çfarëdo mënyrë tjetër apo akoma më tej që ajo nuk do të zbatojë asnjërin nga këto dispozita.

4. Për qëllimet e këtij neni fonogramet e vëna në dispozicion të publikut, me ose pa fill në mënyrë që secili të mund të hyjë në to në vendin dhe në momentin e zgjedhur nga vetë ai, konsiderohen si të publikuara për qëllime tregtare.^{12 13}

Neni 16

Kufizime dhe përjashtime

1. Palët kontraktuese në legjislacionin e tyre mund të parashikojnë kufizime ose përjashtime, të njëjta me ato që i përkasin mbrojtjes së interpretuesve, ekzekutuesve dhe prodhuesve të fonogrameve, sikurse parashikohen në legjislacionin e tyre, lidhur me mbrojtjen e të drejtës së autorit mbi veprat letrare dhe artistike.

2. Palët kontraktuese duhet të ngushtojnë të gjitha kufizimet apo përjashtimet e të drejtave të parashikuara në këtë Traktat, për disa raste të veçanta të cilat nuk konfliktohen me shfrytëzimin normal të interpretimit, ekzekutimit dhe të fonogramit dhe nuk u shkaktojnë dëm të pajustificuar interesave të ligjshme të artistëve interpretues apo ekzekutues ose prodhuesve të fonogramit.^{14 15}

¹². Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 15: Kuptohet që neni 15 nuk prezanton rezolutën e plotë të nivelit të të drejtave të radiopërhapjes dhe komunikimit me publikun që mund të gëzohej nga ekzekutuesit dhe prodhuesit e fonogrameve. Delegacionet e patën të pamundur të arrinin një konsensus të propozimeve të ndryshme për aspektin e garantimit të ekskluzivitetit në disa shembuj ose për garantimin e të drejtave pa mundësinë e rezervimeve dhe kështu e lanë për rezolutën tjetër këtë çështje.

¹³. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 15: Kuptohet se neni 15 nuk parandalon dhënien e të drejtave të përcaktuara nga ky nen ndaj ekzekutuesve të folklorit dhe producentëve të fonogrameve lidhur me folklorin kur këto fonograme nuk janë publikuar për qëllime ekonomike.

¹⁴. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 7,11 dhe 16: E drejta e riprodhimit sikundër del nga neni 7 dhe 11 dhe përjashtimeve të parashikuara nga neni 16, zbatohen plotësisht në ambientin digjital, në veçanti në përdorimin e interpretimeve dhe fonogrameve në formë digjitale. Kuptohet se ruajtja e interpretimeve të mbrojtura dhe fonogrameve në formë digjitale në një mjet elektronik përbën një riprodhim brenda kuptimit të këtij neni.

¹⁵. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 16: Deklarata e miratuar lidhur me nenin 10 (mbi kufizimet dhe përjashtimet) të Traktatit i OBPI-së i të Drejtave të Autorit është i zbatueshëm *mutatis mutandis* edhe për nenin 16 (mbi kufizimet dhe përjashtimet) e TOIEF. (Teksti i Deklaratës së aprovuar lidhur me nenin 10 të TODA kuptohet si më poshtë: “Kuptohet se dispozitat e nenit 10 lejon palët kontraktore të ushtrojnë dhe të shtrijnë në mënyrë të përshtatshme kufizimet dhe përjashtimet e akteve digjitale në ligjet e tyre kombëtare të

Neni 17
Kohëzgjatja e mbrojtjes

(1) Kohëzgjatja e mbrojtjes që i jepet artistëve interpretues apo ekzekutues sipas këtij Traktati nuk duhet të jetë më e vogël se një periudhë prej 50 vjetësh duke filluar nga fundi i vitit kur interpretimi apo ekzekutimi ka qenë fiksuar mbi fonogram.

(2) Kohëzgjatja e mbrojtjes që i jepet prodhuesve të fonogrameve sipas këtij Traktati nuk duhet të jetë më e vogël se një periudhë prej 50 vjetësh, duke filluar nga fundi i vitit kur fonogrami ka qenë publikuar ose në mungesë të një publikimi të tillë, në një afat prej 50 vjetësh duke filluar prej fiksimit të fonogramit, duke u llogaritur prej fundit të vitit të fiksimit.

Neni 18
Detyrime që kanë të bëjnë me masat teknike

Palët kontraktuese duhet të parashikojnë një mbrojtje juridike të përshtatshme dhe sanksione juridike të dobishme, kundër shmangieve të masave teknike të efektshme që janë vënë në veprim prej artistëve interpretues apo ekzekutues apo prej prodhuesve të fonogrameve në kuadrin e ushtrimit të të drejtave të tyre sipas këtij Traktati dhe që ngushtojnë kryerjen (përbushjen) ndaj interpretimeve ose ekzekutimeve apo fonogrameve të tyre, të veprimeve që nuk janë të autorizuar prej artistëve interpretues apo ekzekutues ose prodhuesve të fonogrameve përkatëse që kanë të bëjnë apo që lejohen prej ligjit.

Neni 19
Detyrime që kanë të bëjnë me informacionin mbi regjimin e të drejtave

1. Palët kontraktuese duhet të parashikojnë sanksione juridike të përshtatshme dhe të efektshme kundër çdo personi që kryen një nga veprimet e mëposhtme, me dijeni ose në respekt të sanksioneve civile, duke patur arsye të vlefshme për të menduar që ky veprim do të sjellë, do të bëjë të mundur, do të lehtësojë apo do të fshehë një dëmtim (cenim) të një të drejte të parashikuar prej këtij Traktati:

(i) të heqë apo të ndryshojë, pa autorizim, çdo informacion mbi regjimin e të drejtave që paraqiten në formë elektronike,

(ii) të shpërndajë, të marrë me qëllime shpërndarjeje, të radiopërhapë, t'i komunikojë publikut ose të verë në dispozicion të publikut, pa autorizim interpretime, kopje të interpretimeve, ekzekutimeve të fiksuara apo të fonogrameve duke ditur që informacioni mbi regjimin e të drejtave të paraqitura në formë elektronike janë hequr apo ndryshuar pa autorizim.

2. Në këtë nen, shprehja “informacion mbi regjimin e të drejtave” nënkupton informacionin që identifikon artistin interpretues apo ekzekutues, interpretimin apo ekzekutimin, prodhuesin e fonogramit, fonogramin, titullarin e të gjitha të drejtave mbi interpretimin apo ekzekutimin ose mbi fonogramin apo informacione mbi kushtet dhe mënyrat e përdorimit të interpretimit, ekzekutimit apo fonogramit dhe të çdo numri ose kodi që paraqet informacione, kur njëri çfarëdo prej këtyre elementeve të informacionit i është bashkuar kopjes së një interpretimi, ekzekutimi të fiksuar ose të një fonogrami ose shfaqet e lidhur me komunikimin apo vënien në dispozicion të publikut të interpretimit të fiksuar ose të fonogramit.¹⁶

cilat janë konsideruar të pranueshme nga Konventa e Bernës. Njësoj këto dispozita mund të kuptohen për të lejuar palët kontraktore të ndajnë kufizime dhe përjashtime të reja që janë pikërisht në ambientin e rrjetit digjital;

“është gjithashtu e kuptueshme që neni 10 (2) nuk redukton as shtrin zbatimin e kufizimeve dhe përjashtimeve të lejuara nga Konventa e Bernës”).

¹⁶. Deklarata e aprovuar lidhur me nenin 19: Deklarata e përfshirë në nenin 12 (mbi detyrimet lidhur me informacionin e regjimit të të drejtave) të Traktatit OBPI të të drejtave të autorit është e zbatueshme *mutatis*

Neni 20
Formalitetet

Gëzimi dhe ushtrimi i të drejtave të parashikuara në këtë Traktat nuk varen nga asnjë formalitet.

Neni 21
Rezerva

Kushtëzuar nga dispozitat e nenit 15.3, nuk pranohet asnjë rezervim ndaj këtij Traktati.

Neni 22
Zbatimi në kohë

1. Palët kontraktuese zbatojnë dispozitat e nenit 18 të Konventës së Bernës , mutatis mutandis për të drejtat e artistëve interpretues apo ekzekutues dhe prodhuesve të fonogrameve të parashikuara në këtë Traktat.

2. Megjithë dispozitat e paragrafit (1), një palë kontraktuese mund të kufizojë zbatimin e nenit 5 të këtij Traktati për interpretimet apo ekzekutimet që kanë kryer, pas hyrjes në fuqi të Traktatit, për atë palë.

Neni 23
Dispozita mbi sanksionimin e të drejtave

1. Palët kontraktuese marrin përsipër të përshtasin, në përputhje me sistemin e tyre juridik, masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e këtij Traktati.

2. Palët kontraktuese do të sigurojnë ekzistencën e procedurave ndaluese sipas ligjeve, në mënyrë që të lejojë aksione efektive kundër çdo akti shkeljeje të të drejtave të mbuluara nga ky Traktat, duke përfshirë masa për të parashikuar shpejt dhe për të mënjanuar çdo cenim.

KREU V
DISPOZITA ADMINISTRATIVE DHE KLAUZOLA TË FUNDIT

Neni 24
Asambleja

1. a) Palët kontraktuese kanë një Asamble.
- b) Çdo palë kontraktuese është e përfaqësuar prej një delegati, i cili mund të asistohet prej delegatësh alternativë , këshilltarësh dhe ekspertësh.

mutandis edhe në nenin 19 (mbi detyrimet lidhur me informacionin e regjimit të të drejtave) të Traktatit të OBPI-së (mbi Ekzekutimet dhe Fonogramet) Teksti i deklaratës së aprovuar lidhur me nenin 12 të WCT lexohet si vijon "Kuptohet se referimi ndaj "shkeljes së ndonjë të drejte të mbuluar nga ky Traktat ose të Konventës së Bernës" përfshin si të drejtën ekskluzive ashtu edhe të drejtat e shpërblimit".

"Kuptohet më tej se palët kontraktuese nuk do të bazohen vetëm në këtë nen për të aplikuar ose implementuar sistemet e menaxhimit të së drejtës të cilat do të kenë efektet e imponimit të formaliteteve të cilat nuk lejohen në Konventën e Bernës ose të këtij Traktati, duke ndaluar lëvizjen e lirë të mallrave ose duke penguar gëzimin e të drejtave nën këtë Traktat".

c) Shpenzimet e çdo delegacioni janë marrë përsipër nga pala kontraktuese që e ka caktuar. Asambleja mund t'i kërkojë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (më pas e quajtur OBPI) të akordojë një asistencë financiare për të lehtësuar pjesëmarrjen e delegacioneve të palëve kontraktuese që konsiderohen si vende në zhvillim, në përputhje me praktikën e vendosur prej Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara apo që janë vende në tranzicion drejt një ekonomie tregu.

2. a) Asambleja trajton çështjet që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe zhvillimin e këtij Traktati, si dhe zbatimin dhe funksionimin e tij.

b) Asambleja kryen rolin që i është ngarkuar sipas nenit 26 duke shqyrtuar mundësinë e disa organizatave ndërqeveritare për t'u bërë palë në këtë Traktat.

c) Asambleja vendos thirrjen e çdo konference diplomatike për rishikimin e këtij Traktati dhe i jep udhëzimet e nevojshme Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së për përgatitjen e saj.

3. a) Çdo palë kontraktuese që është një shtet disponon një zë dhe votë të vetme në emër të tij.

b) Çdo palë kontraktuese që është një organizatë ndërqeveritare mund të marrë pjesë në votim, në vend të vendeve të veta anëtare me një numër votash të njëjtë me numrin e vendeve të veta anëtare që janë palë në këtë Traktat. Asnjë organizatë ndërqeveritare nuk merr pjesë në votim në rast se njëri prej vendeve të saj anëtare e ushtron të drejtën e tij të votës dhe anasjelltas.

4. Asambleja mbledhet në seancë të zakonshme një herë në dy vjet nga Drejtori i Përgjithshëm i OBPI-së.

5. Asambleja vendos rregulloren e saj të brendshme përfshirë këtu dhe thirrjen e saj në seancë të jashtëzakonshme, rregullat për kuorum dhe sipas dispozitave të këtij Traktati shumicën e kërkuar për lloje të ndryshme vendimesh.

Neni 25

Byroja ndërkombëtare

Byroja Ndërkombëtare e OBPI-së zbaton detyrat administrative të parashikuara në këtë Traktat.

Neni 26

Kushtet që duhen zbatuar për t'u bërë palë në Traktat

1. Çdo shtet anëtar i OBPI-së mund të bëhet palë në këtë Traktat.

2. Asambleja mund të vendosë të pranojë si palë në këtë Traktat çdo organizatë ndërqeveritare që deklaron se ka kompetencë dhe disponon një legjislacion të vetin që lidh të gjitha shtetet anëtare përsa i përket çështjeve të rregulluara nga ky Traktat dhe që janë të autorizuar, sipas këtyre procedurave të brendshme të bëhet palë në këtë Traktat.

3. Komuniteti Europian që ka bërë deklaratën e paraqitur në paragrafin e mësipërm, gjatë Konferencës Diplomatike që ka adaptuar këtë Traktat, mund të bëhet palë në këtë Traktat.

Neni 27

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky Traktat

Kushtëzuar nga dispozitat specifike në kundërshtim të këtij Traktati çdo palë kontraktuese gëzon të gjitha të drejtat dhe merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin prej tij.

Neni 28

Nënshkrimi i Traktatit

Ky Traktat është i hapur për nënshkrim deri në 31 dhjetor 1997 dhe mund të nënshkruhet prej çdo shteti anëtar i OBPI-së dhe prej Komunitetit Europian .

Neni 29
Hyrja në fuqi e Traktatit

Ky Traktat hyn në fuqi 3 muaj pasi të jenë depozituar prej shteteve, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI, 30 instrumentat e ratifikimit apo të aderimit.

Neni 30
Data efektive e bërjes palë e këtij Traktati

Ky Traktat lidh:

(i) 30 shtetet sipas parashikimeve të nenit 29, duke llogaritur prej datës në të cilin ky Traktat ka hyrë në fuqi.

(ii) Gjithë shtetet e tjera në përfundim të një periudhe prej tre muajsh prej datës në të cilin shteti ka depozituar instrumentin e tij pranë Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së.

(iii) Komunitetin European në përfundim të një afati prej tre muajsh që prej depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit apo aderimit, nëse ky instrument është depozituar pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati, sipas nenit 29 ose në përfundim të tre muajve që pasojnë hyrjen në fuqi të këtij Traktati nëse ky instrument ka qenë depozituar para hyrjes në fuqi të këtij Traktati.

(iv) Çdo organizatë tjetër ndërqeveritare që është pranuar si palë në këtë Traktat pas përfundimit të tre muajve që nga depozitimi i instrumenteve të vet të pranimit.

Neni 31
Denoncimi i Traktatit

Çdo palë kontraktuese mund të prishë këtë Traktat me anë të një lajmërimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë lajmërimin.

Neni 32
Gjuhët e Traktatit

1. Ky Traktat është nënshkruar në një kopje të vetme origjinale në gjuhën franceze, angleze, arabe, kineze, spanjolle dhe ruse, ku të gjitha këto versione janë njëloj autentike.

2. Një tekst zyrtar në çdo gjuhë tjetër, përveç këtyre që janë parashikuar në paragrafin (1), vendoset prej Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së me kërkesën e një pale të interesuar pas konsultimit me të gjitha palët e tjera të interesuara. Për qëllime të këtij paragrafi, me palë të interesuar kuptohet çdo shtet antar i OBPI-së, kur bëhet fjalë për gjuhën e vet zyrtare ose një prej gjuhëve te veta zyrtare. Gjithashtu, Komuniteti European dhe çdo organizatë tjetër ndërqeveritare që mund të bëhet palë në këtë Traktat, kur flitet për një nga gjuhët e veta zyrtare.

Neni 33
Depozitimi

Drejtori i Përgjithshëm i OBPI-së është depozitues i këtij Traktati.

DISPOZITA TË KONVENTËS SË BERNËS PËR MBROJTJEN E PUNËVE LETRARE DHE
ARTISTIKE TË CILAVE U REFEROHET TRAKTATI I MBROJTJES SË INTERPRETIMIT,
EKZEKUTIMIT DHE FONOGRAMAVE

Neni 18

[Punët ekzistuese para hyrjes në fuqi të Konventës: Mundësia e mbrojtjes kur mbrojtja akoma nuk është bërë e vlefshme në vendin e origjinës;

3. Pamundësia e mbrojtjes kur mbrojtja është tashmë e vlefshme në vendin ku është shpallur;

1. Zbatimi i këtyre parimeve

2. Raste të veçanta]

1. Kjo konventë zbatohet për të gjitha veprat, të cilat në momentin e hyrjes në fuqi të saj, nuk kanë rënë akoma në pronën publike të vendit të origjinës nëpërmjet vlefshmërisë së kohëzgjatjes së mbrojtjes.

2. Megjithatë, nëse, nëpërmjet vlefshmërisë së kohëzgjatjes së mbrojtjes së parashikuar më parë, vepra ka rënë në pronësinë publike të vendit në të cilin mbrojtja është shpallur, nuk do të mbrohet sërish.

3. Zbatimi i këtyre parimeve do të varet nga dispozita të përfshira në ndonjë konventë specifike për efektet ekzistuese ose që mund të përfshihen mes vendeve të Bashkimit. Në mungesë të dispozitave të tilla, vendet respektive do të përcaktojnë, secila në masën që i kërkohet, kushtet e zbatimit të këtyre parimeve.

4. Dispozitat e mëparshme do të zbatohen në rastin e një hyrje të re në Bashkim, në rastet e parashikuara në nenin 7 dhe në rastet e shmangies së rezervimit.

Dispozitat e riprodhuara këtu i referohen nenit 22 të TOIEF.

Në tekstin e nënshkruar mungojnë titujt. Titujt janë përfshirë duke iu referuar përmbajtjes së paragrafëve të ndryshëm për të lehtësuar identifikimin e tyre.

DISPOZITAT E KONVENTËS NDËRKOMBËTARE TË MBROJTJES SË EKZEKUTUESVE,
INTERPRETUESVE, PRODHUESVE TË FONOGRAMAVE DHE ORGANIZMAVE TË
RADIOPËRHAPJES (KONVENTA E ROMËS) (1961),
QË I REFEROHET WPPT.

Neni 4-1

[Mbrojtja e Ekzekutimeve, Pika e lidhjes për Ekzekutimet].

Çdo shtet palë u garanton interpretuesve dhe ekzekutuesve trajtim kombëtar, nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

Artisti ekzekutues merr pjese në një nga shtetet kontraktuese;

Ekzekutimi trupëzohet në një fonogram, i cili mbrohet nga neni 5 i Konventës.

(c) Ekzekutimi i pafiksuar në një fonogram, është marrë nga një radiopërhapës i cili mbrohet sipas nenit 6 të kësaj Konvente.

Neni 5-1

[Fonogramet e mbrojtura

1. Pikat e të drejtave të prodhuesve të fonogramave;

2. Publikimet e njëkohshme;

3. Fuqia për të përjashtuar disa kritere]

1. Çdo shtet palë u garanton prodhuesve të fonogrameve trajtim kombëtar, nëse plotësohet një nga kushtet:

(a) prodhuesi i fonogramit është një kombas i një tjetër shteti kontraktues (kriteri i kombësisë);

(b) Fiksimi i parë i tingujve është bërë në një tjetër shtet kontraktues (kriteri i fiksimit).

(c) Fonograma është publikuar për herë të parë në një tjetër shtet kontraktues (kriteri i publikimit).

2. Nëse një fonogram është publikuar për herë të parë në një shtet jokontraktues, por brenda 30 ditësh nga publikimi i saj i parë, është publikuar në një shtet kontraktues (publikim i njëkohshëm), do të konsiderohet si publikimi i parë, ai i bërë në shtetin kontraktues.

3. Sipas kuptimit të lajmërimit të depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, çdo shtet kontraktues mund të deklarojë se ai nuk do zbatojë kriterin e publikimit ose kriterin e fiksimit. Disa njoftime për përjashtimet apo shtimet mund të depozitohen në kohën e ratifikimit, ose kurdoherë më pas; në rastin e fundit ajo do të bëhet efektive 6 muaj pas depozitimit.

Neni 16-3 **Rezervimet**

1. Çdo shtet, pas bërjes palë në këtë Traktat, do të marrë përsipër të gjitha detyrimet dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e shprehura në të.

Megjithatë një shtet në të njëjtën kohë me një njoftim të depozituar në sekretarinë e përgjithshme deklaron se:

(a) Përsa i takon nenit 12:

(i) nuk do të zbatojë dispozitat e atij neni;

(ii) nuk do të zbatojë dispozitat e nenit në funksion të disa përdorimeve;

(iii) për sa i takon fonogramës, prodhuesi i së cilës nuk është kombas i një shteti tjetër kontraktues, ai nuk do ta zbatojë atë nen;

(iv) Mund të kufizohet mbrojtja e garantuar nga neni për shtrirjen dhe për kohën e të cilit, për sa i takon fonogramës, prodhuesi i të cilave nuk është shtetas i një tjetër shteti kontraktues shteti në fjalë garanton mbrojtjen e fonograme fillimisht të fiksuara nga shtetasi i shtetit që bën deklarin; megjithatë fakti që shteti kontraktor prodhuesi i të cilit është shtetas nuk garanton mbrojtjen si shteti që ka bërë deklaratën, nuk do të konsiderohet si një diferencë në shtrirjen e mbrojtjes.

Neni 17 - 4 **[Disa shtete zbatojnë vetëm kriterin e fiksimit]**

Çdo shtet i cili në 26 tetor 1961, garanton mbrojtjen e prodhuesve të fonogramëve vetëm në baze të kriterit të fiksimit mund që me anë të njoftimi depozituar në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në kohën e ratifikimit, pranimit ose shtimit deklaron se do të zbatojë për qëllim të nenit 5 vetëm kriterin e fiksimit dhe për qëllim të paragrafit 1 (a) (iii) dhe (iv) të nenit 16, kriterin e fiksimit në vend të kriterit të atij të kombësisë.

Neni 18 -5 **[Rishikimi i rezervimit]**

Çdo shtet që ka depozituar një njoftim në zbatim të paragrafit (3) të nenit 5, paragrafit (1) të nenit 16 ose nenit 17, mundet që me një njoftim të mëtejshëm të depozituar në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të reduktojë qëllimin ose ta revokojë atë.

LIGJ
Nr. 8741, datë 15.2.2001

PËR SIGURINË NË PUNË NË VEPRIMTARINË MINERARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë punën me një regjim normal dhe brenda kushteve të lejuara për jetën e njeriut në veprimtarinë minerare, si dhe marrjen e masave për shpëtimin e jetës së njerëzve dhe të vlerave materiale në rast avarie dhe kthimin në regjim normal të punës në veprimtarinë minerare.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aktiv shpëtuesish” kuptohen specialistët e minierës që stërviten sipas rregullores së shpëtimit dhe kanë dëshminë e shpëtuesit.
2. “Avari” kuptohet prishja e regjimit normal të punës në veprimtarinë minerare.
3. “Inspektor” kuptohet punonjësi i kualifikuar i RISHM-së që ushtron kontroll në veprimtarinë minerare në zbatim të këtij ligji.
4. “Karrierë” kuptohet çdo vend ku nxirren materiale ose minerale drejtpërdrejt nga sipërfaqja.
5. “Kontroll teknik” kuptohet inspektimi i organizuar, në periudha të caktuara kohe dhe, kur del e nevojshme, jashtë këtyre periudhave, për verifikimin e kërkesave thelbësore të sigurisë në punë.
6. “Minierë” kuptohet çdo gërmim mbi ose nëntokë dhe çdo vend ku shfrytëzohet një pasuri minerare në përputhje me ligjin minerar.
7. “Plan likuidim avarie” kuptohen dokumentet që përmbajnë masat e përcaktuara për shmangien e avarive.
8. “RISHM” kuptohet Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minerave.
9. “Shfrytëzim minerali” kuptohet kryerja e çdo gërmimi, shpimi ose pusi kërkimi ose shfrytëzimi në çdo vendburim minerar, me çfarëdo lloj mënyre, për nxjerrjen e një minerali, duke përfshirë kërkimin, zbulimin dhe përpunimin brenda një trupi minerar.
10. “Shpëtues” kuptohet punonjësi me kualifikim të veçantë që ndërhyr për shpëtimin e jetës së njerëzve dhe për likuidimin e avarive në veprimtarinë minerare.
11. “Subjekt” kuptohet personi juridik ose fizik i pajisur me leje minerare.
12. “Veprimtari minerar” kuptohet tërësia e veprimeve që kryhen në nëntokë dhe në sipërfaqe të minierës për kërkimin, zbulimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e mineralit.
13. “Zjarrmëtar” kuptohet punonjësi me kualifikim të veçantë për ruajtjen, transportin, administrimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse.

KREU II
KËRKESA TË PËRGJITHSHME TË SIGURISË NË PUNË
NË VEPRIMTARINË MINERARE

Neni 3

1. Të gjitha subjektet, që kryejnë veprimtari minerare, studime ose projekte në këtë fushë, janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e sigurisë në punë të vendosura në rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

2. Aktet nënligjore përkatëse nxirren nga Ministria që mbulon veprimtarinë minerare.

Neni 4

Vënia në shfrytëzim

Objekti mineral vihet në shfrytëzim kur:

- a) ka një projekt të miratuar për hapjen, përgatitjen e shfrytëzimin e tij;
- b) plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloret e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë dhe siguron normat për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit;
- c) subjekti që merr lejen minerare është regjistruar në RISHM;
- ç) zotëruesi i lejes minerare zbaton kërkesat e përcaktuara në projektin e miratuar tekniko-teknologjik.

Neni 5

Kontrolli teknik

1. Minierat dhe karrierat i nënshtrohen kontrollit teknik të RISHM-së.

2. Zotëruesi i lejes minerare merr të gjitha masat për të kryer kontrollin teknik periodik, sipas llojit dhe afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të veprimtarisë minerare.

3. Minierat dhe karrierat u nënshtrohen kontrollit teknik periodik të RISHM-së jo më pak se një herë në vit për ruajtjen e kushteve të sigurisë në punë dhe për të zbuluar të metat.

4. Minierat dhe karrierat u nënshtrohen kontrolleve teknike të posaçme të RISHM-së në çdo kohë kur paraqiten rrethana të veçanta që lidhen me vënien në rrezik të minierës, si punime, avari, aksidente ose periudha të zgjatura të mosvënies në shfrytëzim, për t'u siguruar që janë ruajtur kushtet e sigurisë e për të zbuluar e mënjanuar të metat.

5. Kontrollat teknike kryhen nga RISHM-ja ose nga një trup inspektues palë e tretë, e miratuar nga ministri që mbulon veprimtarinë minerare.

Neni 6

Ndërprerja e veprimtarisë minerare

1. Kur RISHM-ja vëren se një minierë ose karrierë rrezikon sigurinë e njerëzve dhe të mjedisit pezullon punën dhe i dërgon ministrisë përkatëse një relacion të motivuar për marrjen e masave të nevojshme për heqjen e lejes minerare.

2. Masa e marrë i bëhet e njohur zotëruesit të lejes minerare. Kundër masës së marrë mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve te ministri që mbulon veprimtarinë minerare.

KREU III
VEPRIMTARIA SHPËTUESE

Neni 7

Veprimtaria shpëtuese në veprimtarinë minerare kryhet nga qendra kryesore e shpëtimit në RISHM-së në bashkëveprim me grupet e shpëtimit të subjekteve minerare.

Neni 8

1. Subjektet minerare, që kanë të punësuar mbi 25 punonjës që punojnë në nëntokë, duhet të organizojnë skuadrën e shpëtimit prej jo më pak se 5 vetash, nga të cilët një duhet të jetë i punësuar si shpëtues, kurse anëtarët e tjerë të skuadrës merren nga aktivi i shpëtuesve të subjektit.

2. Në rastet kur numri i të punësuarve të nëntokës është më i vogël se 25 vetë, subjektet minerare janë të detyruar të kenë skuadra vullnetare shpëtimi.

Neni 9

Rregullat dhe detyrat e grupeve të shpëtimit në miniera dhe në RISHM përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga ministri përkatës.

KREU IV DETYRIME GJATË SHFRYTËZIMIT

Neni 10

Detyrime të zotëruesit të lejes minerare

1. Zotëruesi i lejes minerare merr masat që makineritë, pajisjet, lënda plasëse dhe materialet që përdorin punëmarrësit në miniera të jenë të përshtatshme për punën dhe të garantojnë sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve gjatë përdorimit.

2. Zotëruesi i lejes minerare merr masa që miniera ose karriera, makineritë, pajisjet, lënda plasëse e materialet të mirëmbahen gjatë shfrytëzimit në një nivel të tillë që të plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë në punë.

Neni 11

Informimi i punëmarrësve

1. Zotëruesi i lejes minerare merr masa që punëmarrësi të përvetësojë të dhënat dhe instruksionet e duhura për përdorimin e makinerive, të pajisjeve, të lëndës plasëse dhe të materialeve që ka në përdorim.

2. Të dhënat dhe instruksionet e përdorimit të makinerive, të pajisjeve dhe të lëndës plasëse duhet të përmbajnë të dhënat për sigurinë dhe shëndetin përsa u përket:

- a) kushteve të shfrytëzimit;
- b) situatave anormale të parashikueshme;
- c) mjeteve të mbrojtjes individuale dhe kolektive;
- ç) ndihmës së parë mjekësore në rast aksidenti.

3. Të dhënat dhe instruksionet e pikës 2 të këtij neni duhet të jenë të kuptueshme për punëmarrësin.

Neni 12

Formimi i punëmarrësve

1. Zotëruesi i lejes minerare merr masat e nevojshme që:

- a) punëmarrësit e ngarkuar për përdorimin e makinerive, të pajisjeve dhe të lëndës plasëse të kenë formimin e mjaftueshëm për rreziqet që përmban ky përdorim;
- b) punëmarrësit e ngarkuar me riparimet dhe mirëmbajtjen të kenë kualifikimin dhe formimin e duhur për kryerjen e këtyre detyrave.

2. Krahas kërkesave të pikës 1 të këtij neni, punëmarrësit e përdorimit të lëndës plasëse dhe të shpëtimit në miniera testohen çdo vit nga komisionet teknike të ngritura në RISHM dhe të miratuara nga organi përgjegjës në Ministri.

Neni 13
Këqyrja e avarive

1. Për çdo rast aksidenti ose avarie të rëndë në minierë ose në karrierë, zotëruesi i lejes minerare duhet të njoftojë menjëherë RISHM-në.

2. RISHM-ja shqyrton aksidentet dhe avaritë që ndodhin në veprimtarinë minerare dhe përcakton shkaqet dhe përgjegjësitë, si dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes.

3. Zotëruesi i lejes minerare është i detyruar t'i japë inspektorit, që shqyrton aksidentin ose avarinë, çdo të dhënë që ka lidhje me të.

4. Në rast aksidenti në punë, inspektori i RISHM-së bashkëpunon me inspektorin e punës për këqyrjen e aksidentit.

KREU V
REPARTI I INSPEKTIM-SHPËTIMIT TË MINIERAVE (RISHM)

Neni 14
Statusi

1. RISHM-ja mbikëqyr zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij nga të gjitha subjektet private ose publike vendase ose të huaja që kryejnë veprimtari minerare.

2. RISHM-ja harton rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga ministri që mbulon veprimtarinë minerare.

3. RISHM-ja është organizëm teknik dhe kontrollues në varësi të ministrisë që mbulon veprimtarinë minerare.

4. RISHM-ja është person juridik publik, buxhetor me personel dhe organizim të veçantë. Organizimi, funksionimi dhe struktura e tij miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Drejtuesi i RISHM-së emërohet dhe shkarkohet me vendim të ministrit që mbulon veprimtarinë minerare.

Neni 15
Detyrat e RISHM-së

Krahas detyrave në zbatim të kërkesave të neneve të parashikuara më sipër, RISHM-ja kryen edhe këto detyra:

- a) Bën regjistrimin e subjekteve që punojnë me leje minerare dhe lëndë plasëse.
- b) Kryen inspektime në subjekte private dhe publike vendase dhe të huaja që kryejnë veprimtari minerare në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- c) Mban regjistër për gjendjen teknike për avaritë dhe aksidentët në miniera.
- ç) Lëshon dëshmi për zjarrmëtarët dhe shpëtuesit e subjekteve private dhe publike.

Neni 16
Të drejtat e RISHM-së

1. RISHM-ja, për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ka të drejtë të hyjë në çdo kohë në territorin ku kryhet veprimtari minerare.

2. RISHM-ja, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregulloreve ka të drejtë:

- a) të lërë aktkontroll me detyra dhe afate për përmirësimin e gjendjes;
- b) të lërë aktndalesë për një periudhë kohe të caktuar ose përgjithmonë kur gjykon se procesi teknologjik nuk garanton sigurinë në punë;
- c) t'i propozojë organeve përgjegjëse heqjen e lejes minerare dhe të përdorimit të lëndës plasëse;

ç) të marrë masa administrative, sipas nenit 19 të këtij ligji dhe, për raste shkeljesh të rënda të rregulloreve të sigurimit teknik me pasoja për jetën e njerëzve, të kërkojë ndjekje penale;

3. RISHM-ja kërkon ndërhyrjen e forcave të rendit:

a) kur inspektori dhe shpëtuesi cenohen gjatë kryerjes së detyrës;

b) kur nuk zbatohet urdhri i ndalimit të punës për rastet që përbëjnë rrezik të hapur për jetën e njerëzve;

c) kur nuk lejohet të hyjnë në subjektet të cilat kryejnë veprimtari minerare.

4. RISHM-ja bashkëpunon me shërbime përkatëse publike ose private, për të kryer ekspertiza për krijimin e grupeve të punës dhe për kryerjen e kontrolleve të veçanta e të aksioneve të shpëtimit të njerëzve.

Neni 17

Burimet financiare

Burimet financiare të RISHM-së janë:

Buxheti i Shtetit;

b) të ardhurat me destinacion, që realizohen nga shërbimet për të tretët.

2. RISHM-ja realizon të ardhura nga shërbimet që kryen për subjektet private ose publike nga:

a) veprimtaria kryesore sipas neneve 4, 5 dhe 12 të këtij ligji. Këto të ardhura derdhen në Buxhetin e Shtetit. Tarifat për këto të ardhura caktohen nga Ministria e Financës në bashkëpunim me ministrinë që mbulon veprimtarinë minerare;

b) të ardhurat me destinacion nga shërbimet për të tretët. Këto të ardhura derdhen në llogarinë e RISHM-së dhe përdoren për mbulimin e shpenzimeve të kryera, ndërsa 10 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit. Tarifat për këto të ardhura caktohen nga ministria që mbulon veprimtarinë minerare.

Neni 18

Pavarësia e paanshmëria

1. Punonjësve të RISHM-së u ndalohet të kenë interesa të drejtpërdrejta ose të tërthorta me subjektet ku ato ushtrojnë kontroll.

2. Inspektorët e RISHM-së duhet të kenë formim të mirë tekniko-profesional, njohje të kënaqshme të kërkesave për kryerjen e detyrës dhe aftësi për të hartuar dokumentacionin për kontrollet e bëra.

3. Shpëtuesit e RISHM-së duhet të jenë të gatshëm dhe të aftë nga ana shëndetësore për të kryer aksione shpëtimi, në përputhje me rregulloren e Planit të Emergjencës për Miniera.

4. RISHM-ja ka personelin, uniformën dhe mjetet e nevojshme për të kryer në mënyrë të përshtatshme funksionet teknike dhe administrative të kontrollit dhe të shpëtimit, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 19

Kundërvajtjet administrative

1. Janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkeljet e dispozitave të neneve 3, 4, 5, 8, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji që rrezikojnë sigurinë e njerëzve, të kafshëve shtëpiake dhe të vlerave materiale;

b) shkeljet e përsëritura të shënuara në aktkontrollet e lëna nga RISHM-ja;

c) tejkalimi i afatit të lënë nga RIMSH-ja për mënjanimin e shkeljeve.

2. Kur shkelja nuk përbën vepër penale, zotëruesi i lejes minerare, punonjësi i caktuar për mbikëqyrje teknike dhe punëmarrësi dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë.

Inspektori i RISHM-së që vëren shkeljen, harton në vend procesverbalin dhe vendos gjobën.

3. Masa e gjobës është nga 2 mijë deri në 500 mijë lekë. Llogaritja e gjobës bëhet sipas mënyrave të përcaktuara në rregulloret e RISHM-së të miratuara nga ministri që mbulon veprimtarinë minerare.

4. Kundërvajtjet administrative shqyrtohen jo më vonë se 15 ditë nga data e mbajtjes së procesverbalit nga Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave të RISHM-së që mblidhet dhe drejtohet nga Kryeinspektori.

5. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet në prani të kundërvajtësit. Kur vërtetohet se ai ka marrë dajeni dhe nuk ka shkaqe justifikuese për mosparaqitje, shqyrtimi mund të bëhet edhe në mungesë të tij.

6. Kundër vendimit të komisionit të shqyrtimit të gjobave mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 20

Ekzekutimi i vendimeve me gjobë

1. Gjopa paguhet nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati për çdo ditë vonesë paguhet, një kamatë prej 2 përqindësh deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati gjopa nuk paguhet, atëherë zbatohet ligji nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

2. Gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 21

Çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2910, datë 27.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIGJ

Nr. 8742, datë 15.2.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE TË ZHVILLIMIT (IDB) PËR PROJEKTIN E INFRASTRUKTURËS RURALE “

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit (IDB) për projektin e infrastrukturës rurale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2911, datë 27.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE

E HUASË MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE TË ZHVILLIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË INFRASTRUKTURËS NË SHQIPËRI

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në _____ / 1419 H korresponduese e 8.11.2000/ 2000 G midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (e quajtur më poshtë “Huamarrësi”) dhe Bankës Islamike të Zhvillimit (referuar më poshtë “Banka”).

NDËRSA,

(A) Huamarrësi i ka kërkuar Bankës të ndihmojë në financimin e Projektit të Infrastrukturës Rurale në Shqipëri (i quajtur më poshtë “Projekti”) siç përshkruhet në Skedarin II të kësaj Marrëveshjeje duke dhënë një hua siç parashikohet më poshtë:

(B) Një nga qëllimet e Bankës është të ndihmojë vendet e saj anëtare, nëpërmjet dhënies së huave për të financuar projekte dhe programe produktive;

(C) Projekti është konsideruar teknikisht i plotë ekonomikisht dhe financiarisht i justifikuar;

(D) Banka është dakord bazuar sa më sipër t’i japë kredi Huamarrësit me afatet dhe kushtet e parashtruara këtu më poshtë:

TANI SI RRJEDHOJË, palët këtu bien dakort si vijon:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme. Përkufizimet

Seksioni 1.01. Kushtet e Përgjithshme: Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha klauzolat e Kushteve të Përgjithshme që i aplikohen Marrëveshjes së Huasë e Garancisë së Bankës, datë 8.11.1976 (të quajtura më poshtë “Kushtet e Përgjithshme”), me të njëjtën forcë sikur të ishin përcaktuar këtu.

Seksioni 1.02. Përkufizimet: Të gjitha termat e përdorura në këtë Marrëveshje, kudo ku ato janë përdorur, përderisa konteksti nuk e kërkon ndryshe, kanë të njëjtin kuptim me ato të përdorura dhe të përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme. Ndërsa termat shtesë kanë kuptimet që vijojnë:

(a) “Data Effektive” do të thotë data në të cilën Marrëveshja është deklaruar efektive nga Banka dhe i është komunikuar Huamarrësit nga Banka.

(b) “Agjensi Ekzekutive” do të thotë Fondi i Zhvillimit Shqiptar (FZSHS), e cila është Agjensia Ekzekutive përgjegjëse për zbatimin, menaxhimin dhe drejtimin e Projektit. FSHZH-ja do të implementojë nënprojektet sipas prioritetit të caktuar nga Ministria e Punës e Çështjeve Sociale.

(c) “Projekti” siç është parashikuar në Skedarin II të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

Seksioni 2.01. Shuma. Banka është dakort t’i japë Huamarrësit, nga burimet e saj të zakonshme, një shumë e cila nuk e kalon ekuivalentin prej vetëm 4,889,000 DI (katërmilion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë Dinarë Islamikë). Dinari Islamik, siç është përcaktuar në Nenin 4 (1) (a) të Marrëveshjes për themelimin e Bankës është ekuivalent me një “E drejtë Speciale e Tërheqjes (SDR)” të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Seksioni 2.02. Huamarrësi do t'i vërë në dispozicion të FSHZH-së të ardhurat e huasë për të financuar pjesë të kostos së huaj të Projektit në përputhje me këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.03. Me përjashtim të rastit kur Banka do të bjerë dakort ndryshe, kontratat për mallra e shërbime për t'u financuar jashtë procedurave të kësaj Huaje, do të sigurohen sipas procedurave të caktuara në skedulin IV të kësaj Marrëveshje, siç mund të ndryshohen ato kohë pas kohe. Në këtë kontekst, Huamarrësi do t'i përmbahet rregullores së Konferencës Islamike lidhur me Bojkotimin e Izraelit.

Neni 3

Amortizimi, taksa e shërbimit dhe vendet e pagimit

Seksioni 3.01. Amortizimi. Huamarrësi do të kthejë shumën kryesore të Huasë në 25 (njëzet e pesë) vjet, përfshirë këtu edhe 7 (shtatë) vjet periudhën favorizuese, duke filluar nga data e kësaj Marrëveshje, në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta dhe të njëpasnjëshme për çdo 6 (gjashtë) muaj, siç është paraqitur në Skedarin I (A) të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 3.02. Taksat e Shërbimit

(a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një Taksë Shërbimi për shumën e vlerësuar fillimisht në vetëm 482.518,00 (katërqind e tetëdhjetë e dymijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) DI (Dinarë Islamikë), sipas mënyrës së dhënë në Skedarin e kësaj Marrëveshje.

(b) Të dyja palët janë marrë vesh dhe kanë ranë dakort se shuma fillestare e Taksës së Shërbimit e përcaktuar në Nën-Seksionin 3.02 (a) këtu më sipër, nuk është më shumë se një vlerësim i bazuar në parashikimin e periudhës së zbatimit dhe periudhës së disbursimit të të gjithë shumës së Huasë, siç është parashikuar më sipër. Është rënë dakort më tej, që shuma aktuale e Taksës së Shërbimit do të llogaritet pas zbatimit të Projektit, duke patur parasysh që shuma aktuale e llogaritur në këtë mënyrë, nuk do të kalojë më shumë se 2.5% (dy pikë pesë përqind) të shumës së Huasë për vit.

(c) Taksa e Shërbimit do të fillojë nga data e kësaj Marrëveshje.

Seksioni 3.03. Vendet e Kryerjes së Pagesave. Të gjitha pagesat, përfshirë edhe kthimin e shumës kryesore do të konsiderohen të kryera siç duhet, kur fondet që përbëjnë këto pagesa janë kredituar në llogarinë e caktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 3.04. Pa paragjykuar përgjithësimet e klauzolave të Seksionit 3.03, të gjitha pagesat do të konsiderohen të kryera siç duhet kur:

(a) Nëse kjo pagesë është bërë në Dollarë US kur njëra nga Bankat që vijojnë i konfirmon BIZH-së faturën e një pagese të tillë në llogarinë e Bankës Islamike të Zhvillimit.

(i) Account No.001591.11

Saudi International Bank

99, Bishopsgate, London EC 2M 3TB

Telex Numbers: 8812261, 8812262.

(ii) Account No.B10507

Arab Banking Corporation

P.O. Box: 5698, Manama, Bahrain

Telex Numbers: 9385, 9431/2/3, 9442 ABCBAH BN

(b) Nëse kjo pagesë është bërë në Franga Franceze, kur Banka në vijim i konfirmon BIZH-së faturën e një pagese të tillë në llogarinë e Bankës Islamike të Zhvillimit:

Account No. 96965.9.001.00

Union De Banques Arabes Et Francaises (U.B.A.F.)

190 Avenue Charles de Gaulle

92523 Neuilly Cedex, France

Telex-Number: 610334 UBAFRA

(c) Nëse kjo pagesë është bërë në Paund Stërlina, kur Banka në vijim i konfirmon BIZH-së faturën e një pagese të tillë në llogarinë e Bankës Islamike të Zhvillimit:

Account No.708372

Gulf International Bank

2-6 Canon Street, London EC 4M 6XP,
Telex Numbers: 8813326, 8812889

Neni 4

Tërheqjet dhe perdorimi i të ardhurave të kredisë

Seksioni 4.01. Tërheqjet. Shuma e Huasë mund të tërhiqet nga Huamarrësi, subjekt i Skedarit II dhe IV, si dhe i të gjithë klauzolave të kësaj Marrëveshje, i Kushteve të Përgjithshme dhe procedurave të disbursimit të Bankës, për qëllimet e parashtruara në këtë Marrëveshje, për shpenzime të kryera duke respektuar kosto e çmime të arsyeshme, për mallra e shërbime të kërkuara që do të financohen nën këtë Marrëveshje.

Seksioni 4.02. Data e Kërkimit të disbursimit të Parë. Nëse brenda 180 ditëve nga data e bërjes efektive ose një date të mëvonshme të rënë dakord midis Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi nuk ka dërguar kërkesën Bankës për të bërë disbursimin e parë, Banka mund të anulojë këtë marrëveshje pasi të ketë lajmëruar Huamarrësin.

Seksioni 4.03. Data e Përfundimit. Data 31.12.2004, apo një date më e vonë se kjo siç mund të jetë rënë dakord midis Huamarrësit dhe Bankës, është data e mbylljes për tërheqje nga Kredia për qëllimet e Seksionit 6.03 (c) të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 4.04. Përdorimi i të Ardhurave të Kredisë. Të gjitha shumat e tërhequra nga Huamarrësi nga Llogaria e Huasë do të përdoren vetëm për qëllime të Projektit financiar nga Banka.

Neni 5

Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 5.01. Huamarrësi do të bëjë që FSHZH-ja:

(a) Të ekzekutojë Projektin dhe të drejtojë veprimet dhe çështjet e tij me efikasitetin dhe angazhimin e duhur dhe në përputhje me praktika të plota administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike nën mbikëqyrjen dhe administrimin e një personeli të kualifikuar dhe në përputhje të plotë me planin e investimeve, buxhetin, planet dhe specifikimet që kanë të bëjnë me Projektin, të dorëzuar dhe aprovuar nga Banka.

(b) T'i paraqesë Bankës për aprovim, të detajuara, nëse Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, çdo modifikim të rëndësishëm të parashikuar për buxhetin, planet dhe specifikimet e projektit si dhe çdo ndryshim esencial në çdo kontratë për shërbime apo prokurim mallrash lidhur me ekzekutimin e Projektit.

Seksioni 5.02. Pa asnjë detyrim apo kufizim tjetër mbi secilin prej obligimeve të tij nën këtë Marrëveshje, Huamarrësi do t'i lejojë Bankës një afat kohor të arsyeshëm të komentojë ndonjë ndryshim esencial apo ndonjë shtrirje të kohës së kushtëzuar në ndonjë kontratë për shërbime apo prokurim mallrash lidhur me ekzekutimin e Projektit.

Neni 6

Para-Kërkesa shtesë para disbursimit nga Banka

Seksioni 6.01. Huamarrësi, para paraqitjes së aplikimit të parë për tërheqje, tregon procedurën që ai propozon të ndiqet apo çështjet që duhen ndjekur për ekzekutimin e Projektit në pajtim me Skedulën IV të kësaj Marrëveshjeje dhe të marrë nga këtu miratimin e Bankës.

Neni 7

Kontrata të veçanta

Seksioni 7.01. Huamarrësi do të vërë në dispozicion në mënyrë të menjëhershme të gjitha shumat, përfshirë koston e monedhës lokale, koston e tejkualuar që do të nevojiten për realizimin e Projektit, në afate dhe kushte të kënaqshme për Bankën.

Seksioni 7.02. Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve për t'u financuar nga kjo hua do të bëhen në përputhje me procedurat e dhëna në Skedulën IV.

Seksioni 7.03. Huamarrësi do të bëjë që FSHZH-ja t'i japë Bankës menjëherë pas aprovimit të tyre nga Huamarrësi, studimet, planet dhe specifikimet për Projektin, planin e ekzekutimit të tij dhe çdo modifikim material të bërë aty më pas, në atë detaje sa do të kërkojë Banka herë pas here.

Seksioni 7.04. Huamarrësi do të bëjë që FSHZH të krijojë dhe mbajë regjistrime për të identifikuar mallrat e financuara nga Huaja dhe të zbulojë përdorimin e tyre në Projekt dhe të reflektojë në përputhje me parime të shëndosha të kontabilitetit, operacionet dhe situatën financiare të FSHZH-së.

Seksioni 7.05. Huamarrësi do të mbështesë me mjete të arsyeshme që përfaqësuesit e Bankës të kryejnë vizita për qëllime që lidhen me Huanë, dhe për të inspektuar Projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe shënim përkatës; dhe do t'i japë Bankës gjithë atë informacion që Banka në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë lidhur me shpenzimin e të ardhurave të Huasë, Projektin, mallrat dhe operacionet dhe gjendjen financiare të Agjensisë Ekzekutive.

Seksioni 7.06. Huamarrësi merr përsipër për realizimin dhe operimin e Projektit, të bëjë rregullime të përshtatshme të FSHZH në çdo kohë të funksionojë nën rregullore, në formë e përmbajtje të kënaqshme për Bankën dhe të ketë fuqi të tilla menaxhimi dhe administrimi të nevojshme për realizimin e operimin eficient të Projektit.

Seksioni 7.07. Huamarrësi do të sigurojë me siguri me reputacion mallrat e blera me Huanë. Ky sigurim do të përmbajë transportin detar, tranzitin dhe risqe të tjera rastësore për blerjen e importimin e mallrave në territorin e Huamarrësit dhe dërgimin në zonën e Projektit dhe do të jetë për ato shuma që janë në përputhje me praktika të shëndosha tregtare. Ky sigurim do të bëhet në përputhje me ligjet e Huamarrësit duke pasur parasysh që sigurimi do të ripaguhet në monedhë të huaj.

Seksioni 7.08. Huamarrësi do të ndërmarrë gjithë ato veprime që do të gjykojnë të nevojshme për të vënë në dispozicion si dhe kur duhet gjithë të drejtat dhe pronësitë përse i përket tokës siç do të kërkojë për realizimin e Projektit dhe do t'i japë Bankës, me kërkesën e saj, dëshmi të kënaqshme për Bankën që të drejta dhe pronësi të tilla në lidhje me tokën janë vënë në dispozicion për Projektin.

Seksioni 7.09. Huamarrësi do të ndërmarrë gjithë ato veprime që do të jenë të nevojshme nga ana e tij për të aftësuar FSHZH-në të ekzekutojë Projektin dhe nuk do të ndërmarrë, apo të lejojë të ndërmerret ndonjë veprim i cili do ta pengonte apo ndërhynte në ekzekutimin apo operimin e Projektit apo respektimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10. Të gjitha dokumentet, shënimet, korrespondenca e Bankës dhe materiale të tjera të ngjashme do të konsiderohen nga Banka dhe Huamarrësi si çështje konfidenciale.

Neni 8 **Raportet**

Seksioni 8.01.

(a) Huamarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar plotësimin e qëllimeve të Huasë. Për këtë qëllim, secili prej tyre do t'i japë tjetrit gjithë atë informacion që në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë lidhur me gjendjen e përgjithshme të Huasë. Nga ana e Huamarrësit ky informacion do të përfshijë kushtet ekonomike financiare të territorit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Huamarrësit.

(b) Huamarrësi dhe Banka kohë pas kohe me kërkesën e secilës prej palëve, do të shkëmbejnë pikëpamje përmes përfaqësuesve të tyre me qëllim të diskutimit të çështjeve që lidhen me Huanë, mirëmbajtjen e shërbimeve dhe realizimin nga Huamarrësi të obligimeve nën këtë Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02.

(a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë paraqitjen apo ngarkon të tjerë për t'i parqitur Bankës me pëlqimin e plotë të saj dhe në kohën e specifikuar për secilin, raportet që vijojnë:

(i) Brenda 90 ditëve pas fundit të çdo tremujori kalendarik, ose brenda një periudhe tjetër të tillë siç mund të bien dakord palët, raporte mbi ekzekutimin e Projektit në mënyrë që Banka herë pas here mund të specifikojë.

(ii) Raporte të tilla, siç Banka mund t'i kërkojë, në mënyrë të arsyeshme, lidhur me investimin e shumave të Huasë së dhënë dhe progresin e Projektit.

(iii) Menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në çdo rast, jo më vonë se gjashtë muaj nga Data e Mbylljes apo një date tjetër më e vonë siç mund të jetë rënë dakort midis Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi do të përgatisë dhe japë Bankës një Raport përfundimtar, lidhur me qëllimin dhe me detajet sa Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, mbi ekzekutimin dhe veprimet fillestare të Projektit.

(b) Dokumentet e përshkruara në këtë Seksion do të vërtetohen me zgjedhjen e Bankës, në atë mënyrë që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Neni 9

Efektiviteti dhe data e angazhimit

Kjo Marrëveshje nuk do të bëhet efektive përderisa:

(A) (1) Bankës nuk i është dhënë evidencë e kënaqshme që ekzekutimi dhe lëvrimi i kësaj Marrëveshjeje nga ana e Huamarrësit është autorizuar siç duhet apo është ratifikuar nga të gjitha instancat qeveritare të nevojshme.

(2) Huamarrësi nuk i ka dhënë Bankës një Opinion Ligjor të pranueshëm të lëshuar nga një Autoritet Legal Qeveritar, që deklaron se Marrëveshja e Huasë është autorizuar dhe firmosur rregullisht nga ana e Huamarrësit. Deklarata duhet të pohojë që Marrëveshja përbën një obligim ofertë mbi Huamarrësin në përputhje me afatet e saj.

(B) Një letër Autorizimi duhet të lëshohet nga Ministria e Financave ose nga një organ tjetër i Qeverisë autorizuar rregullisht Bankës Qendrore apo njësisë që kryen funksionet e Bankës Qendrore duke e instruktuar këtë Bankë që pagesa nga Qeveria nën këtë Marrëveshje të Huasë dhe e kësteve të Taksës së Shërbimeve, do të kryhet nga Banka Qendrore apo njësia që kryen funksionet e një banke Qendrore në datat që kërkon skadimi. Një kopje e kësaj Letre Autorizimi së bashku me një njohje nga Banka Qendrore apo njësia që kryen funksionet e Bankës Qendrore, që tregon se ajo ka marrë Letrën e Autorizimit, të cituar më sipër dhe që ajo t'i përmbahet instruksioneve të dhëna aty, do t'i jepen nga Qeveria Bankës.

Neni 10

Mbarimi i Marrëveshjes nga dështimi për t'u bërë efektive

Në rast se Marrëveshja nuk do të ketë hyrë në fuqi brenda 180 ditëve nga data e nënshkrimit, Marrëveshja dhe gjithë detyrimet e palëve këtu më sipër do të mbarojnë me përjashtim të rastit kur Banka, pasi të ketë marrë parasysh të gjitha arsyet e vonësës, do të vendosë një datë më të vonë për zbatimin e këtij Neni. Banka do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë më të vonë.

Neni 11

Klauzola të ndryshme

Seksioni 11.01. Përfaqësues të Autorizuar. Ministria e Financave e Huamarrësit është përcaktuar si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për qëllimet e Seksionit 10.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 11.02. Data e Marrëveshjes. Për gjithë qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data do të jetë ajo që do të duket në Hyrje.

Seksioni 11.03. Adresat. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 10.01. të Kushteve të Përgjithshme:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
Për Bankën Islamike të Zhvillimit:
P.O.Box;5925
Jeddah 21432
Kingdom of Saudi Arabia
Teleks: 601137 ISDBSJ
Teleg: BANKISLAMI JEDDAH
Telefaks: 6366871 JEDDAH

NË DËSHMI, Banka dhe Huamarrësi, duke vepruar secili me përfaqësuesit e tij, kanë firmosur këtë dokument në gjuhën angleze në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Zj. ERMELINDA MEKSI
MINISTER I BASHKËPUNIMIT
EKONOMIK DHE TREGTISË

PËR DHE NË EMËR TË BANKËS ISLAMIKE
TË ZHVILLIMIT
Zt. AHMET MUHAMETALI
DREJTOR I BANKËS ISLAMIKE
TË ZHVILLIMIT

SKEDARI - I (A)
PAGESA TË KAPITALIT THEMELOR

Shuma e Huasë4,889,000 DI
Periudha e Huasë25 vjet
Periudha Grace:7 vjet
Pagesa e Shërbimit482,518 DI

Pagesa nr.	Datë	Principali
1.	31 Dhjetor 2007	135,750.00
2.	30 Qershor 2008	135,750.00
3.	31 Dhjetor 2008	135,750.00
4.	30 Qershor 2009	135,750.00
5.	31 Dhjetor 2009	135,750.00
6.	30 Qershor 2010	135,750.00
7.	31 Dhjetor 2010	135,750.00
8.	30 Qershor 2011	135,750.00
9.	31 Dhjetor 2011	135,750.00
10.	30 Qershor 2012	135,750.00
11.	31 Dhjetor 2012	135,750.00
12.	30 Qershor 2013	135,750.00
13.	31 Dhjetor 2013	135,750.00
14.	30 Qershor 2014	135,750.00
15.	31 Dhjetor 2014	135,750.00
16.	30 Qershor 2015	135,750.00
17.	31 Dhjetor 2015	135,750.00
18.	30 Qershor 2016	135,750.00
19.	31 Dhjetor 2016	135,750.00
20.	30 Qershor 2017	135,750.00
21.	31 Dhjetor 2017	135,750.00
22.	30 Qershor 2018	135,750.00
23.	31 Dhjetor 2018	135,750.00

24.	30 Qershor 2019	135,750.00
25.	31 Dhjetor 2019	135,750.00
26.	30 Qershor 2020	135,750.00
27.	31 Dhjetor 2020	135,750.00
28.	30 Qershor 2021	135,750.00
29.	31 Dhjetor 2021	135,750.00
30.	30 Qershor 2022	135,750.00
31.	31 Dhjetor 2022	135,750.00
32.	30 Qershor 2023	135,750.00
33.	31 Dhjetor 2023	135,750.00
34.	30 Qershor 2024	135,750.00
35.	31 Dhjetor 2024	135,750.00
36.	30 Qershor 2025	135,750.00
Totali:		4.889.000

**SKEDARI – I (B)
TAKSA E SHËRBIMIT**

Projekti:Infrastruktura Rurale, Shqipëri
Shuma e Huasë:4,889,000 DI
Periudha e Huasë:25 vjet
Periudha Grace:7 vjet
Pagesa e shërbimit:482,518 DI

	Datë	Pagesa e shërbimit (DI)
1.	31 Dhjetor 2000	19,300.70
2.	30 Qershor 2001	38,601.44
3.	31 Dhjetor 2001	38,601.44
4.	30 Qershor 2002	38,601.44
5.	31 Dhjetor 2002	38,601.44
6.	30 Qershor 2003	38,601.44
7.	31 Dhjetor 2003	27,021.01
8.	30 Qershor 2004	27,021.01
9.	31 Dhjetor 2004	27,021.01
10.	30 Qershor 2005	27,021.01
11.	31 Dhjetor 2005	27,021.01
12.	30 Qershor 2006	27,021.01
13.	31 Dhjetor 2006	27,021.01
14.	30 Qershor 2007	27,021.01
15.	31 Dhjetor 2007	27,021.01
16.	30 Qershor 2008	27,021.01
Totali i pagesës së shërbimit		482,518.00

**SKEDULI II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

Projekti ka për qëllim të përmirësojë kushtet social-ekonomike të njerëzve në 36 nga 37 rrethe të Shqipërisë (d.m.th. 270 nga 400 komuna), të cilat radhiten si më të prekurat nga numri më i madh i familjeve të varfra nga mbështetja sociale e shtetit. rreth 500,000 familje do të përfitojnë nga projekti:

Projekti përfshin:

1. Rrugët rurale (450 km)
2. Ujësjellës (70 skema)
3. Shkolla fillore (30)
4. Zyra administrative të komunave (20)
4. Shërbime konsulence
6. PIU

SKEDULI III TËRHEQJA E HUASË

Komponenti Kosto në USD milion

1. Nën-projekte (270) 5.380
2. Shërbime konsulence 0.150
3. PIU 0.150
4. Toleranca 1.136

Totali: 6.816

SKEDULI IV PROCEDURA PËR PËRGATITJEN DHE MIRATIMIN E NËN-PROJEKTEVE, PROKURIMI I MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE DHE DISBURSIMI I FONDEVE PËR PUNIMET RURALE TË FINANCUARA NGA IDB

1. Huaja e IDB do të shpërndahet në 270 projekte, përfshirë rrugët rurale, ujësjellësin, ujitjen, qendrat e shkollës dhe shëndetësisë sipas Programit të Punëve Rurale. Kjo shumë nuk do të kalojë 6.816 milion si përllogaritje.

2. Nënprojektet do të formulohen, përpunohen, miratohen dhe implementohen nga FSHZH-ja, që varet nga Këshilli i Ministrave.

3. Programi i Punëve Rurale do të formulohet dhe zhvillohet nga këshilli i komunës bazuar në udhëzimet e FSHZH-së. Çdo nënprojekt do të vlerësohet nga stafi teknik i FSHZH-së bazuar në vlerësime teknike, ekonomike, financiare dhe të mjedisit. Mbi bazën e raportit të vlerësimit të stafit teknik, komiteti ekzekutiv i FSHZH-së do të aprovojë nënprojekte para disbursimit të fondeve.

4. Për çdo nënprojekt të aprovuar, do të nënshkruhet një kontratë standarde midis FSHZH-së dhe këshillit të komunës për ekzekutimin e nënprojektit. Banka bie dakord për ndërtimin e nënprojekteve rurale nëpërmjet "Forcë Account" d.m.th. duke përdorur ekspertë të Qeverisë ose të tjerë të disponueshme në zonën e projektit. Kontratat do të jepen mbi baza konkurruese në zonat ku ka kontraktorë lokalë.

5. Për të lehtësuar disbursimin e shpejtë, Banka me pëlqimin e Qeverisë, mund të autorizojë FSHZH-në të hapë një fond "revolving" në BSH ku të paktën 25% e shumës së Huasë së Bankës do të paguhet në fillim nga IDB.

6. FSHZH do të autorizohet të disbursojë fonde nga fondi "revolving" për nënprojekte në përputhje me procedurën e disbursimit të rënë dakord me Bankën, FSHZH dhe BSH.

7. Mbushja e fondit "revolving" do të bëhet nga Banka pasi të ketë marrë evidencë të kënaqshme d.m.th. fatura të vërtetuara nga Komiteti Ekzekutiv i Bordit të FSHZH-së dhe kundërfirmuar nga Zyra e Drejtimit të UNOPS-it që shpenzimet janë bërë në përputhje me procedurat e miratuara në nënprojekte dhe një raport progresi që pohon se punimet janë mbaruar siç duhet. Një kërkesë për mbushjen e fondit fillestar do të bëhet nga Qeveria e Shqipërisë në emër të FSHZH-së kur të disbursohen 60% të fondeve.

VENDIM
Nr. 473, datë 26.2.2001

PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 6 pika 6 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores të Kuvendit, me propozimin e Mbledhjes së Përfaqësuesve të Pushtetit Vendor,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

- I. Zonja Liri Jani dhe zoti Shahin Bistri zgjidhen anëtarë të Komisionit të Shërbimit Civil.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 474, datë 1.3.2001

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT ILIR ZEÇO, ANËTAR I KOMISIONIT TË LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 3 pika 3 të ligjit nr. 8080 "Për letrat me vlerë" dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores të Kuvendit,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Miratohet dekreti nr.2903, datë 16.2.2001 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Zeço në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë, në vend të zonjës Albina Karamitro, e cila ka dhënë dorëheqjen.

- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 58, datë 2.2.2001

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.575, DATË 2.9.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FURNIZIMIN ME KARBURANTE TË NDËRMARRJEVE E TË INSTITUCIONEVE, BUXHETORE DHE JOBUXHETORE, NGA "ALBPETROL", SH.A, PATOS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Vendimin nr.575, datë 2.9.1996 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 64, datë 2.2.2001

**PËR INKUADRIMIN E GRADAVE USHTARAKE, NË GRADAT E POLICISË SË SHETITIT
DHE PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, QË DO TË USHTROHEN SIPAS TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 22, të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit” dhe të neneve 7,8,24, dhe 26, të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Inkuadrimi i gradave ushtarakëve të personelit të Policisë së Shtetit, të fituara sipas ligjit nr.7550, datë 13.9.1993, “Për gradat në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me gradat e përcaktuara sipas ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, të bëhet në përputhje me vjetërsinë e shërbimit, kualifikimin, karrierën dhe funksionin që kanë në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Funksionet organike, që do të mbulohen nga punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas gradave, përcaktohen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Paga bazë për funksionet sipas gradave bëhet me vendim të veçantë.

3. Inkuadrimi në gradë i punonjësit të policisë, bëhet si vijon:

a) Në rolin bazë:

a/1 Punonjësi i policisë merr gradën “Agjent”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Kapter” (polic) apo “Kapter IV” (polic IV) dhe ka vjetërsi shërbimi jo më shumë se 2 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej më pak se 3-javësh.

a/2 Punonjësi i policisë merr gradën “Agjent i parë”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Kapter” (polic), “Kapter IV” (polic IV) ose “Kapter III” (polic III) dhe ka vjetërsi shërbimi nga 2 deri në 4 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej jo më pak se 3 javësh.

a/3 Punonjësi i policisë merr gradën “Asistent”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Kapter IV” (polic IV), “Kapter III” (polic III) ose “Kapter II” (polic II) dhe ka vjetërsi shërbimi nga 4 deri në 7 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.07.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej jo më pak se 3 javësh.

a/4 Punonjësi i policisë merr gradën “Asistent i parë”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Kapter III” (polic III), “Kapter II” (polic II) ose “Kapter I” (polic I) dhe ka vjetërsi shërbimi nga 7 deri në 15 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej jo më pak se 3 javësh.

a/5 Punonjësi i policisë merr gradën “Kryeasistent”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Kapter II” (polic II) ose “Kapter I” (polic I) dhe ka vjetërsi shërbimi më shumë se 15 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej jo më pak se 3 javësh.

a/6 Punonjësi i Policisë së Shtetit që ka kryer shkollat e formimit bazë, përkatësisht Institutit 1 (një) ose 2 (dy)-vjeçar, dhe ka vjetërsi shërbimi, jo në pak se 2/3-ta e vjetërsisë së parashikuar për çdo gradë, fiton gradën respektive për vjetërsinë e nevojshme për gradë, të parashikuar nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000.

b) Në rolin e mesëm:

b/1 Punonjësi i policisë merr gradën “Nëninspektor”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Nëntoger” ose “Toger” dhe ka vjetërsi shërbimi jo më shumë se 2 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej 16 javësh.

b/2 Punonjësi i policisë merr gradën “Inspektor”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Nëntoger”, “Toger” ose “Kapiten” dhe ka vjetërsi shërbimi nga 2 deri në 4 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej 6 javësh.

b/3 Punonjësi i policisë merr gradën “Kryeinspektor”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Toger”, “Kapiten” ose “Kapiten i parë” dhe ka vjetërsi shërbimi nga 4 deri në 8 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej 16 javësh.

c) Në rolin e lartë:

c/1 Punonjësi i policisë merr gradën “Nënkomisar”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Kapiten”, “Kapiten i parë” ose “Major” dhe ka vjetërsi shërbimi nga 8 deri në 10 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej 24 javësh.

c/2 Punonjësi i policisë merr gradën “Komisar”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Major”, “Nënkolonel” ose “Kolonel” dhe ka vjetërsi shërbimi nga 10 deri në 14 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në 3 vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej 24 javësh.

c/3 Punonjësi i policisë merr gradën “Kryekomisar”, kur në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mban gradën “Nënkolonel” apo “Kolonel” dhe ka vjetërsi shërbimi nga 14 deri në 16 vjet. Kur nuk ka kualifikimet e nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në tri vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej 24 javësh.

d) Në rolin madhor:

d/1 Grada “Drejtues” i jepet punonjësit të Policisë së Shtetit, i cili në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në mbështetje të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, mban gradën Kolonel dhe ka vjetërsi shërbimi nga 16 deri në 18 vjet, ka kryer Akademinë e Rendit Publik (Policisë) dhe kanë jo më pak se 10 vjet në funksione drejtuese, në strukturat e policisë, pas përfundimit të kursit të parashikuar në pikën 3, të nenit 15 të ligjit të sipërpërmendur.

d/2 Grada “Drejtues i parë” i jepet punonjësit të Policisë së Shtetit, i cili në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në mbështetje të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 mban gradën “Kolonel” dhe ka vjetërsi shërbimi jo më pak se 18 vjet, ka kryer Akademinë e Rendit Publik (Policisë) dhe ka jo më pak se 15 vjet në funksione drejtuese, në strukturat e policisë, pas përfundimit të kursit të parashikuar në pikën 3, të nenit 15 të ligjit të sipërpërmendur.

4. Punonjësit e Ministrisë së Rendit Publik ose të organeve, qendrore e vendore, të cilët punojnë me cilësinë e këshilltarit ose në funksione të ngjashme me të, për probleme të rendit e të sigurisë publike, fitojnë gradë, sipas kriterëve të parashikuara në paragrafet c/2, c/3 dhe d/1, të pikës 3 të këtij vendimi, në varësi të gradës që kanë mbajtur në çastin e kalimit në funksionet që mbajnë.

5. Forma dhe ndërtimi i gradave në Policinë e Shtetit përcaktohet në lidhjen nr.2 (albumi), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ministria e Rendit Publik merr masa për plotësimin e personelit të policisë, sipas modeleve të gradave, të miratuara 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

7. Përcaktimet në vendimin nr.351, datë 1.8.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e gradave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, që përcaktojnë gradat në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik dhe që bien në kundërshtim në këtë vendim, shfuqizohen.

8. Pjesët e vendimit nr.642, datë 20.11.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për formën dhe ndërtimin e gradave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, që përcaktojnë gradat e sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

FUNKSIONET SIPAS GRADAVE

GRADA	FUNKSIONET
Drejtues i Parë/Drejtues	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm
Drejtues/Kryekomisar	Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të P.Sh., ose Drejtor Drejtorie në Ministrinë e Rendit Publik Drejtori i Policisë së Qarkut Tiranë, Drejtor i Akademisë së Policisë
Kryekomisar/Nënkomisar	Shef Sektori (autonom) në Drejtorinë e Përgjithshme të P.Sh; Zëvendësdrejtor i Akademisë; Sekretar i Përgjithshëm i Akademisë Drejtor Instituti i Policisë Shkencore, Shef Departamenti në Akademinë e Policisë, Shef Sektori në D.P.P.Sh., ose në Ministrinë e Rendit Publik; Drejtor i Drejtorisë së Policisë në Qark; si dhe funksione të barazvlershme me to...
Komisar/Nënkomisar	Shef Zyre në D.P.P.Sh., ose në Ministrinë e Rendit Publik; Shef Komisariati Kat.1; Shef Departamenti në Akademinë e Policisë; Përgjegjës Departamenti në Institutin e Policisë Shkencore; Shef i Qendrës së Profilaksisë e Mjekimit; Pedagog në Akademinë e Policisë; Shef Sektori në D.P.Q., Tiranë; Komandant R.E.N.E.A., R.O.S., Reparte F.N.Sh.; funksione të barazvlershme me to
Nënkomisar/Kryeinspektor	Specialist në D.P.P.Sh, ose në Ministrinë e Rendit Publik; Shef Komisariati Kat.2; Specialist në Institutin e Policisë Shkencore; Pedagog në Akademinë e Policisë; Komandant i Rep.100; Komandant Nënreparti F.N.Sh.; Shef Sektori në D.P.Q., funksione të barazvlershme me to
Kryeinspektor/Inspektor	Specialist në Drejtorinë e Qarkut, Shef Sektori në Komisariat kat.1, Shef Rajoni Policie; Zv.Komandant - Shef shtabi R.E.N.A.R.O.S. etj., Komandant Rep.324
Inspektor/Nënspektor	Shef zyre komisariati kat.1; Shef sektori Kom.Kat 2; Shef Shtabi në Rep. F.N.Sh.; funksione të barazvlershme me to
Nënspektor	Inspektor policie kriminale; Komandant toge; Shifrant; Specialist; Specialist Policie Shkencore; repartit rendit, F.N.Sh; funksione të barazvlershme me to
Kryeasistent/Asistent 1	Komandant Poste Policie; Përgjegjës V.K.T; Llogaritar 1; Teknik elektronik për aparaturat; funksione të barazvlershme me to
Asistent i 1/Asistent	Ndihmës oficer informacioni e gatishmërie; Kujdestar; Kujdestar-magazinier; Skuadërkomandant; funksione të barazvlershme me to
Asistent/Agjent 1	Agjent i Policisë Kriminale; Inspektor i Policisë së Rendit; Magazinier; funksione të barazvlershme me to

Agjent i 1/Agjent	Përgjegjës patrulle; Ndihmës i Inspektorit të Policisë së Rendit; Polic në qarkullimin rrugor; shofer për shërbimet; funksione të barazvlershme me to
Agjent	Punonjës patrulle; polic roje objekti; funksione të barazvlershme me to

LIDHJA 2
GRADA E POLICISË SË SHTETIT

Format e gradave të Policisë së Shtetit, për të gjitha nivelet, paraqiten në Spaleta me ngjyrë të zezë (ngjyrë qëndrueshmërie e serioziteti) me përmasa 6x13 cm (tubolare).

Gradat paraqiten me ngjyrë të artë (ngjyrë pushteti dhe triumfi)

Ndarja e gradave për të katër nivelet realizohet në mënyrë specifike brenda dhe jashtë tyre, por ajo që i bashkon ato në një pikë janë dy ngjyrat bazë: e zeza dhe ajo e artë si dhe buzimi i spaletës në gjatësi me ngjyrë të artë.

UDHËZIM
Nr. 1, datë 24.1.2001

PËR FUNKSIONIMIN E KRRT-VE

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe deri në përcaktimin me ligj të një zgjidhjeje tjetër,

U D H Ë Z O J:

1. Të funksionojnë KRRT-të e ngritura në 13 bashkitë sipas përcaktimit të bërë në nenin 15 të ligjit “Për Urbanistikën”.

2. Në çdo bashki e komunë, ku aktualisht nuk ka zyrë apo seksion urbanistike, të përmirësohet struktura organizative për të mundësuar zbatimin e detyrave që rrjedhin nga ligjet e sipërpërmendura.

3. Në çdo rreth të funksionojnë KRR-të nën drejtimin e prefektit, në përputhje me nenin 75 të ligjit nr. 8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Anëtarë të KRRT-së janë personat e përmendur në nenin 18 të ligjit të urbanistikës, që i gëzojnë atributet e cituara në atë nen.

4. KRRT-ja në rreth funksionon në përputhje me nenin 21 të ligjit të urbanistikës me përjashtim të kompetencës për miratimin e shesheve dhe lejeve të ndërtimit e cila sipas ligjit nr.8652, nga 1 janari 2001 i kalon komunave dhe bashkive.

5. Kuptimi i nenit 72 pika 5/1 “c” e ligjit nr.8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, deri në një zgjidhje tjetër ligjore do të jetë: Këshillat e komunave dhe bashkive janë plotësisht përgjegjëse për miratimin e shesheve dhe lejeve të ndërtimit vetëm në kushtet e ekzistencës së studimeve të plota apo pjesore të miratuara për zonat përkatëse nga organet e specializuara, sipas përcaktimeve në ligjin nr.8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe aktet nënligjore të dalta për dhe në zbatim të tij.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Bashkim Fino

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Hajredin Fuga,	Anëtari ““
Alfred Karamuço,	Anëtari ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Sabri Rrapi,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 12.1.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.98/4 Akti, që i përket:

KËRKUES: ALUSH ALLKJA, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani.

OBJEKTI: Deklarimin si antikushtetues të vendimeve nr.119. datë 13.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr.253, datë 28.12.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.78, datë 25.2.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31 germa “a, b dhe ç”; 32/2, 42/2 të Kushtetutës dhe 6 pika I-rë e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Kërkuesi, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve:

I) Në gjykimin e shkallës së parë, lidhur me veprimet proceduese të prokurorisë, konstatohen një sërë shkeljesh kushtetuese:

a) Akuza nuk i është komunikuar të gjykuarit menjëherë e hollësisht dhe mbi të gjitha, nuk është njoftuar familja për fillimin e procedimit penal të vrasjes, duke u shkelur nenet 31/a të Kushtetutës dhe 141/1 të Kodit të Procedurës Penale.

b) Janë bërë një sërë veprime procedurale, pa praninë e mbrojtjes, kërkesë e parashikuar nga nenet 141/1, 3 dhe 296 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

c) Koha e pamjaftueshme për të realizuar mbrojtjen është shkelje tjetër kushtetuese e parashikuar nga neni 31 germa “b” e Kushtetutës. Gjatë gjykimit u paraqit një provë e qenies në Greqi të të gjykuarit, por gjykata nuk kërkoi plotësimin e saj.

ç) Gjykata e shkallës së parë, pranoi në seancën e tretë të procesit paraqitjen e provave (gjashtë deklaramë dëshmitarësh), të cilat nuk ishin në dosjen hetimore më datë 5.2.1999, kur nga prokuroria u bë procesi për njohjen e të pandehurit me materialet e çështjes.

II) Gjykata e Apelit Durrës, duke zhvilluar gjykimin pa praninë e të pandehurit, ndonëse ka kërkuar të marrë pjesë, ka sjellë pasojë për të pandehurin.

III) Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, duke mos pranuar rekursin për gjykim është një shkelje e rëndë procedurale penale.

Nga ai Kolegj është shkelur e drejta e mbrojtjes, e sanksionuar në nenin 33 të Kushtetutës dhe në nenin 6, pika 3, germa “c” e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata nuk i jep përgjigje rekursit në të cilin janë ngritur probleme ligjore për një proces të drejtë e të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi relatorin, gjyqtarin Sabri Rrapi, shpjegimet e përfaqësuesit të kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Alush Allkja me vendimin nr.119, datë 13.10.1999 të Gjykatës së rrethit Elbasan, është deklaruar fajtor për veprën penale të vrasjes me dashje me paramendim, në dëm të viktimës Afrim Uruçi dhe për atë të armëmbajtjes pa leje, të parashikuara respektivisht nga neni 78 dhe 278/2 të Kodit Penal dhe dënuar përfundimisht me 24 vjet burgim.

Mbi ankimin e të gjykuarit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.253, datë 28.12.1999 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çështjen mbi bazën e rekursit të paraqitur nga i gjykuari, e ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit dhe ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se “rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale dhe se vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan dhe nga ajo e Apelit Durrës, janë të drejta dhe të bazuara në ligj”.

Nga gjykimi i kësaj çështje në seancë plenare, Gjykata Kushtetuese konstatoi, se në të tria shkallët e gjykimit nga gjykatat e zakonshme vërehen shkelje të rënda procedurale, të cilat e bëjnë procesin të parregullt. Shkelje antikushtetuese janë bërë që në fazën e hetimit. Gjatë hetimit, nuk është komunikuar akuza menjëherë e hollësisht, pasi organi i hetimit nuk ka caktuar mbrojtës që të komunikonte akuzën e të pandehurit, i cili ishte në mungesë, duke shkelur nenin 31/a të Kushtetutës.

I pandehuri nuk është njohur me të gjitha materialet në ngarkim të tij, nga prokurori para se çështja të kalonte për gjykim, siç janë gjashtë deklaramet e personave që kanë dijeni për çështjen, të cilat nuk ishin në dosjen hetimore më datën 5.2.1999 kur nga prokurori është bërë procesi për njohjen e të pandehurit me materialet e çështjes. Këto prova janë paraqitur vetëm në gjykatën e shkallës së parë pas disa seancave, me kërkesë të gjykatës. Në këtë vështrim, është shkelur e drejta e mbrojtjes të të gjykuarit.

Konstatohet gjithashtu, se nga data 27.7.1998 që është regjistruar çështja e të gjykuarit nga organet e hetimit dhe deri në datën 1.2.1999 që është caktuar mbrojtës, janë bërë një sërë veprimesh procedurale pa praninë e mbrojtësit, ç’ka përbën shkelje të garancisë për realizimin në kohë të mbrojtjes (neni 31/b i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë). Dosja hetimore ka kaluar për gjykim më datën 5.2.1999, dmth. 4 ditë pas pjesëmarrjes së mbrojtësit, çka ka sjellë pamundësinë objektive në hetuesi për të realizuar mbrojtje efikase e në kohë.

Nga materialet e çështjes nxirret konkluzioni, se gjykata e shkallës së parë që e ka deklaruar fajtor të pandehurin, e ka marrë të mirëqenë akuzën, duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë që parashikohet nga neni 6, pika 2 e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nga neni 4 i Kodit të Procedurës Penale. Në këto dispozita parashikohet, se çdo person i akuzuar për një shjellje të ligjit prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Cenimi i këtij parimi të rëndësishëm procedural nga ana e gjykatës tregon se nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor, që shprehet qartë në qëndrimin e mbajtur nga gjykata ndaj alibisë së pretenduar nga i pandehuri, sipas të cilit, në kohën e krimit ndodhej në Greqi.

Gjykata Kushtetuese konkludon, se shkeljet procedurale të rëndësishme të lejuara nga organi i akuzës dhe nga gjykata e shkallës së parë që ka deklaruar fajësinë e të pandehurit, nuk i ka korrigjuar as Gjykata e Apelit, as Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Apelit jo vetëm që nuk i ka konstatuar shkeljet e lartpërmendura, por ajo vetë ka bërë shkelje të rënda procedurale, pasi nuk e ka siguruar paraqitjen e të gjykuarit, i cili ka kërkuar me insistim të thirrej për t’u dëgjuar në atë Gjykatë.

Edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është i cenueshëm. Kështu, Kolegji Penal ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit të paraqitur nga i pandehuri me arsyetimin, se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Nga përmbajtja e rekursit që ka paraqitur i gjykuari në Kolegjin Penal del, se në të janë ngritur shkaqe që kanë të bëjnë me mosrespektimin e normave procedurale. Këto shkelje të rënda me karakter procedural dhe kushtetues, siç u përmendën më lart në këtë vendim, nuk janë vlerësuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili në këto kushte, ishte i detyruar ta kalonte çështjen për gjykim në seancë dhe jo në dhomën e këshillimit siç ka vepruar.

Nga ana tjetër, vendimi i Kolegjit Penal është i cenushtëm sepse megjithëse nuk ka pranuar rekursin, është shprehur në themel për çështjen në paragrafin e dytë të tij kur pranon se “vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan dhe nga Gjykata e Apelit Durrës janë të drejta dhe të bazuara në ligj”. Në dhomën e këshillimit, nuk mund të vendoset mbi drejtësinë ose jo të vendimeve të shkallëve më të ulta, por vetëm në seancë gjyqësore dhe me pjesëmarrjen e palëve.

Gjykata Kushtetuese, përfundimisht konkludon, se gjykatat e të tria shkallëve kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut; për rrjedhojë duhet të shfuqizohen vendimet e tyre dhe çështja të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës dhe 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.19, datë 13.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr.253, datë 28.12.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.78, datë 25.2.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 7.2.2001

Nr. 98/4 i Regj.Themeltar

Nr. 4 i Vendimit

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 15.3.2001
Doli nga shtypi më 16.3.2001

Tirazhi: 4200 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”

Çmimi: 150 lekë